



PROJEKT- RREGULLORE E ANALIZËS SË TREGJEVE

Dokument për Këshillim Publik

Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të AKEP, Nr.27, datë 14.11.2025

Kjo Rregullore është nxjerrë në bazë të parashikimit të pikës 1, të nenit 89 të ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Komunikime Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji 54/2024), duke mbajtur në konsideratë: ligjin Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar; Direktivën (BE) 2018/1972 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 11 dhjetor 2018 “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”; Rekomandimet e Komisionit Evropian për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve brenda sektorit të komunikimeve elektronike të ndjeshme ndaj rregullimit “*ex-ante*” (EU) 2020/2245; Udhëzuesin e Komisionit Evropian mbi analizat e tregut, si dhe vlerësimet e fuqisë së ndjeshme në treg sipas rregullores së BE-së për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (C/2018/2374).

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton mënyrën e zbatimit të procesit të analizës së tregut, të përkufizimit të tregjeve përkatëse, identifikimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) dhe vendosjen e masave rregullatore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Metodologjia e përdorur

1. AKEP, konsideron përcaktimin e tregjeve për rregullim ‘*ex-ante*’, në përputhje me udhëzuesin “Për procesin e analizës, përcaktimin e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg (FNT) në sektorin e komunikimeve elektronike”, si edhe kriteret ligjore që mundësojnë përkufizimin dhe vlerësimin e tregjeve, dhe mbi këtë bazë:
 - a. Në përputhje me nenet 87 dhe 89 të Ligjit nr. 54/2024, si dhe duke mbajtur në konsideratë listën e tregjeve të rekomanduara nga Komisioni Evropian, përfshirë edhe rrethanat e veçanta kombëtare, përcakton tregjet e justifikuara për ndërhyrje ‘*ex-ante*’;
 - b. Vlerëson sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg në përputhje me nenin 88 të Ligjit nr. 54/2024;
 - c. Vendos, mban, ndryshon ose heq detyrimet rregullatore sipas përcaktimeve në nenin 92 të Ligjit nr. 54/2024.
2. Dokumenti i analizës së tregut përveç të tjera, përmban:
 - a. Përkufizimin e detajuar të tregut përkatës, duke përfshirë dimensionin e produktit/shërbimit si dhe shtrirjen gjeografike të tij;
 - b. Testin e tre kriterëve, kur është i nevojshëm, në përputhje me nenin 87 dhe 89 të Ligjit nr. 54/2024;

- c. Analizën për FNT dhe detyrimet rregullatore për sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg në përputhje me nenin 90 të këtij ligji;
 - d. Specifikimi i detyrimeve të veçanta rregullatore mund të kryhet me akte të tjera të AKEP, në përputhje me nenin 92 të Ligjit nr. 54/2024.
3. Për qëllime të analizës së tregut, AKEP përdor të dhëna statistikore dhe financiare periodike të dërguara periodikisht nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike. Nëse nevojiten të dhëna shtesë, kërkon dhe administron këto të dhëna në përputhje me nenin 41 të ligjit nr. 54/2024. Në kërkesat për të dhëna, AKEP përcakton formatin dhe afatet kohore për dorëzimin e tyre. Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike janë të detyruar të paraqesin të dhënat sipas kërkesave të AKEP.
 4. Gjithashtu, në dokumentet e analizave të tregut, AKEP mund të përdorë të dhëna shtesë nga raporte të ndryshme ndërkombëtare apo praktika të mira pune, që mund të konsiderohen nga vendet e rajonit apo BE-së dhe që përmbushin kriteret e krahasimit për produkte/shërbime pjesë të tregut përkatës që analizohet;
 5. Në kryerjen e analizës së tregut, AKEP merr në konsideratë edhe:
 1. Udhëzimet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian dhe BEREC në fuqi për procesin e analizës së tregjeve të komunikimeve elektronike dhe vlerësimin e FNT në këto tregje;
 2. Udhëzimet dhe përcaktimet e ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në fuqi;
 3. Praktika të mira ndërkombëtare nga vendet e rajonit apo BE-se që përmbushin kriteret e krahasimit për produkte/shërbime pjesë të tregut përkatës që analizohet.

Neni 3

Lista e tregjeve përkatëse

1. AKEP analizon për FNT tregjet përkatëse të mëposhtme¹ si tregje të mundshme për ndërhyrje ‘ex-ante’ në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenet 87 dhe 89 dhe 90 të Ligjit nr. 54/2024 dhe Rekomandimin e Komisionit Evropian për tregjet e rregulluara ‘ex-ante’:
 1. Tregu me shumicë i aksesit lokal në një vendndodhje fikse;
 2. Tregu me shumicë i aksesit në kapacitete të dedikuara;
 3. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të telefonisë fikse;
 4. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të telefonisë së lëvizshme.

¹ Aneks II i kësaj rregulloreje, përmban një përmbledhje të arsyetuar e përcaktimit të tregjeve përkatëse për ndërhyrje ‘ex-ante’, në reference të Rekomandimit të Komisionit Evropian (EU) 2020/2245, i cili përcakton tregjet relevante të produkteve dhe shërbimeve në sektorin e komunikimeve elektronike që janë të ndjeshme ndaj rregullimit ‘ex-ante’, sipas Direktivës (EU) 2018/1972, duke synuar një kuadër referues për harmonizimin e metodologjisë së AKEP me standardet e BE-së, përmbledhje e cila shpjegon mënyrën e identifikimit të tregjeve përkatëse të përcaktuara nga BE si të rregullueshme dhe të mundshme për ndërhyrje ‘ex-ante’.

2. AKEP mund të përcaktojë dhe analizojë tregje të tjera, të cilat nuk janë pjesë e listës në pikën 1, nëse vlerësohet e nevojshme për qëllime rregullimi, në përputhje me nenin 87 dhe 89 të Ligjit nr. 54/2024 dhe udhëzimet e Komisionit Evropian dhe BEREC.
3. Përkufizimi i detajuar i tregjeve përkatëse, dimensionit gjeografik dhe produktit/shërbimit, do të jenë pjesë e dokumentit të analizës së tregut të hartuar nga AKEP.
4. Nëse AKEP analizon një treg që nuk është pjesë e listës në nenin 3 (pika 1) ose e listës së rekomanduar nga KE në fuqi, në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 89, të ligjit 54/2024, vlerëson nëse ky treg plotëson testin e tre kriterëve (kriteret e përcaktuara edhe në rekomandimet/udhëzimet në fuqi të KE) që përmbushen njëherazi 3 kushtet e mëposhtme në këto tregje:
 - a. verifikimi i prezencës së barrierave të larta dhe jokolimtare të hyrjes;
 - b. verifikimi nëse një strukturë tregu nuk ka tendencë për të shkuar në drejtimin e një konkurrence efektive brenda një afati kohor përkatës;
 - c. vlerësimi nëse aplikimi vetëm i ligjit në fuqi, që rregullon fushën e konkurrencës, është ose jo i mjaftueshëm për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dështimin e tregut të marrë në shqyrtim.
5. Nëse një treg nuk plotëson një nga 3 kriteret, AKEP nuk e analizon këtë treg për FNT dhe nuk vendos detyrime rregullatore në këtë treg ose anulon detyrimet ekzistuese, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 54/2024.

Neni 4

Rishikimi i përcaktimit të tregut dhe analizës së tregut

1. AKEP-i kryen analizën e tregjeve përkatëse të identifikuara sipas përcaktimeve të ligjit nr. 54/2024 në mënyrë periodike, në përputhje me nenin 87 dhe 90 të këtij ligji, sipas afateve në vijim:
 - a. brenda pesë vjetësh nga data e vendimit të mëparshëm të AKEP-it për përcaktimin e sipërmarrësve në fuqi të ndjeshme në një treg përkatës, të përcaktuar në rregulloren e AKEP-it;
 - b. brenda tre vjetësh nga data e ndryshimit të rregullores për përcaktimin e tregjeve përkatëse, në përputhje me rekomandimet e Bashkimit Evropian, për tregjet e pa analizuar më parë;
 - c. brenda tre vjetësh nga data e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
 - d. në raste përjashtimore e të justifikuara, afati i përcaktuar në shkronjën “a” me sipër mund të shtyhet jo më shumë se një vit. AKEP-i njofton ministrin për arsyet e shtyrjes së afatit për analizën e tregut të paktën katër muaj para përfundimit të afatit.

2. Nëse faktet dhe rrethanat që justifikuan përfundimet e procesit të analizave të mëparshme kanë ndryshuar dhe nuk pasqyrojnë më situatën aktuale në treg, AKEP rishikon përfundimet dhe vendimet përkatëse, duke përfshirë:
 - a. Përcaktimin e tregut përkatës;
 - b. Vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg (FNT);
 - c. Detyrimet rregullatore të vendosura ndaj sipërmarrësve me FNT.
3. Në rast se një treg nuk plotëson më kriteret për ndërhyrje ex-ante, AKEP mund të vendosë heqjen ose ndryshimin e detyrimeve rregullatore, në përputhje me nenet 90 dhe 92 të Ligjit nr. 54/2024.
4. Gjatë rishikimit të analizës së tregut, AKEP merr parasysh:
 - a. Ndryshimet në strukturën e tregut dhe konkurrencën;
 - b. Evolucionin teknologjik dhe zhvillimet e tregut;
 - c. Rekomandimet dhe udhëzimet e Komisionit Evropian dhe BEREC për analizën e tregjeve.

Neni 5

Procedurat për Konsultim dhe Publikim

1. Në përputhje me nenet 44 dhe 45 të Ligjit nr. 54/2024, AKEP përpara marrjes së vendimeve dhe masave rregullatore për sipërmarrësit e përcaktuar me FNT në tregjet përkatëse, merr dhe vlerëson mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet procesit të këshillimit publik. Afati i zhvillimit të procesit të konsultimit publik nuk mund të jetë më pak se 30 ditë, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme.
2. Publikimi i rezultateve të analizave të tregjeve dhe masat që do të ndërmerren për rregullimin e tregjeve, vendimmarrjeve përkatëse të Këshillit Drejtues të AKEP bëhen në përputhje me nenin 24 të Ligjit nr. 54/2024, duke siguruar transparencë dhe informim për publikun dhe aktorët e tregut.

Neni 6

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të dokumentit përfundimtar nga Këshilli Drejtues i AKEP dhe publikimit në faqen zyrtare të AKEP, në përputhje me nenin 24 të Ligjit nr. 54/2024.
2. Rregullorja nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e Tregut”, e miratuar me VKD nr. 747, datë 17.07.2009, e ndryshuar me VKD nr. 2342, datë 31.07.2013, shfuqizohet.

ANEKS I — UDHËZIM PËR PROCESIN E ANALIZËS, PËRCAKTIMIN E TREGUT DHE VLERËSIMIN E FUQISË SË NDJESHME NË TREG (FNT) NË SEKTORIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

(në referencë të Ligjit nr. 54/2024, si dhe në përputhje me Udhëzuesin e Komisionit Evropian për analizën e tregut)

1. Hyrje

1.1. Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i tij është të kontribuojë në zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike, si edhe të sigurojë zbatimin e një praktike të harmonizuar, transparente dhe të bazuar në prova, në përputhje me parimet dhe praktikatat e aplikuara në vendet e Bashkimit Evropian.
2. Ky udhëzues përcakton metodologjinë, parimet dhe procedurat për analizën e tregjeve të komunikimeve elektronike dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg (FNT), në përputhje me Kreun XIII dhe Kreun XIV të Ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike” dhe udhëzimet metodologjike të Komisionit Evropian “*Guidelines on Market Analysis and the Assessment of Significant Market Power under the EU Regulatory Framework for Electronic Communications Networks and Services*” (SWD(2018) 124 final).
3. Udhëzuesi për FNT adreson në mënyrë specifike aspekte që kanë të bëjnë me përcaktimin e tregut, si edhe përcaktimin e FNT individuale apo FNT e përbashkët.
4. Udhëzuesi zbatohet nga AKEP për analizat ‘ex-ante’ të tregjeve për rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike. Ai shërben si dokument orientues për operatorët e tregut dhe palët e interesuara në procesin e hartimit të dokumenteve të analizave të tregut të AKEP, konsultimin publik dhe vendimmarrjen pasuese.
5. AKEP mund të ndërmarrë rishikimin e udhëzuesit për FNT, kur e gjykon të arsyeshëm, kur merr në konsideratë vendimmarrjen e gjykatës për çështje të caktuara të lidhura me këtë proces, si edhe aspekte ekonomike apo zhvillimet e tregut me objektiv që këto rishikime të garantojnë proporcionalitet në zhvillimin e shpejtë të këtyre tregjeve.

1.2. Parime dhe objektiva rregullatorë

6. AKEP-i përcakton tregjet përkatëse kombëtare të komunikimeve elektronike dhe produktet përkatëse, të cilat justifikojnë rregullimin dhe janë subjekte të rregullimit të veçantë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, me parimet e ligjit për konkurrencën dhe kushtet aktuale të tregut shqiptar, duke mbajtur në konsideratë kërkesat e rregullimit të veçantë në sektor dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve.
7. Analiza e tregut kryhet në përputhje me parimet e proporcionalitetit, transparencës, paanshmërisë dhe objektivitetit. Roli i rregullatorit është të sigurojë që ndërhyrja ‘ex-ante’ bëhet vetëm në tregjet ku konkurrenca efektive mungon dhe bazohet në të dhëna të verifikueshme dhe vlerësime ekonomike sipas kritereve të përcaktuara në Ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike” dhe praktikave më të mira të punës.
8. AKEP, në ushtrimin e kompetencave të tij, ndjek objektivat e përcaktuara në nenin 5 të Ligjit nr. 54/2024, përfshirë:

- a) promovimin e konkurrencës efektive dhe investimeve efikase;
 - b) mbrojtjen e interesave të përdoruesve përfundimtarë;
 - c) garantimin e neutralitetit teknologjik dhe promovimin e konvergjencës së rrjeteve e shërbimeve;
 - d) sigurimin e një mjedisi të qëndrueshëm rregullator dhe parashikueshmërisë për investitorët.
9. Në frymën rregullatore, përcaktimi i tregut përkatës dhe vlerësimi për fuqi të ndjeshme në treg duhet të bazohet në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës. Kur shqyrtojnë çështje të ngjashme në rrethana të ngjashme dhe me të njëjtat objektiva të përgjithshme, autoritetet kombëtare rregullatore (NRA-të) dhe autoritetet e konkurrencës, parimisht, duhet të arrijnë në përfundime të ngjashme. Megjithatë, duke pasur parasysh dallimet në fushëveprim dhe objektiva të ndërhyrjes së tyre, dhe në veçanti fokusin dhe rrethanat e veçanta të vlerësimit të NRA-ve, siç përcaktohet në këtë udhëzues, tregjet e përcaktuara për qëllime të legjislacionit të konkurrencës dhe ato të përcaktuara për qëllime të rregullimit sektorial mund të mos jenë gjithmonë identike.
10. Në mënyrë të ngjashme, përcaktimi i një sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg, në një treg të identifikuar për qëllime të rregullimit ‘ex-ante’, nuk nënkupton automatikisht se ky sipërmarrës është gjithashtu me pozitë dominuese për qëllime të zbatimit të legjislacionit të konkurrencës.
11. Në praktikë, nuk mund të përjashtohet që procedura paralele, të iniciuara në kuadër të rregullimit ‘ex-ante’ legjislacioni sektorial dhe ‘ex-post’ të legjislacionit për konkurrencën, të zbatohen për lloje të ndryshme problemesh të konkurrencës të identifikuara në tregjet përkatëse me pakicë. Në këtë kuadër, detyrimet ‘ex-ante’ të vendosura nga AKEP ndaj sipërmarrësve me FNT në treg synojnë të adresojnë dështimet e tregut të identifikuara dhe të përmbushin objektivat specifike të përcaktuara në kornizën rregullatore. Nga ana tjetër, ndërhyrjet rregullatore ‘ex-post’ nëpërmjet instrumenteve të legjislacionit për konkurrencën kanë për qëllim të trajtojnë dhe eliminojnë shqetësimet që lidhen me marrëveshje të ndaluara, praktika të bashkërenduara ose sjellje abuzive të njëanshme, të cilat kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën në tregun përkatës.

1.3. Korniza ligjore dhe përkufizimet kryesore

12. Korniza ligjore që mbështet këtë udhëzues përfshin ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike”, veçanërisht Kreun XIII dhe Kreun XIV; Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar; Direktivën (BE) 2018/1972 dhe Udhëzuesin e Komisionit Evropian (SWD(2018)124 final); Rekomandimin (EU) 2020/2245 mbi tregjet relevante të produkteve dhe shërbimeve.

2. Përcaktimi i tregut përkatës për rregullim ex-ante

13. AKEP përcakton tregjet e produktit/shërbimit dhe tregjet gjeografike përkatëse mbi bazën e përcaktimeve të ligjit 54/2024, duke mbajtur maksimalisht në konsideratë kriteret teknike, ekonomike dhe me vlerësimet e përdorura nga Komisioni Evropian në Rekomandimin (EU) 2020/2245.

14. Procesi nis me tregjet e rekomanduara nga Komisioni, por AKEP mund të analizojë edhe tregje të tjera të pa-listuara kur ekzistojnë arsye objektive dhe kur identifikohen sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr. 54/2024.
15. Gjatë kryerjes së analizës së tregut në përputhje me nenin 89 të Ligjit nr. 54/2024, AKEP do të zhvillojë një vlerësim strukturor të tregut përkatës duke marrë parasysh zhvillimet e ardhshme të pritshme të tregut të analizuar për periudhën përkatëse. Kohëzgjatja e periudhës së rishikimit të tregut fillon në përfundim të analizës e cila është në proces dhe përfundon në përfundim të periudhës së rishikimit pasardhës të tregut, gjatë së cilës AKEP duhet të vlerësojë karakteristikat dhe zhvillimet e tregut përkatës.
16. Pikënisja për identifikimin e tregjeve me shumicë që janë të prirura për rregullim ‘ex-ante’ duhet të jetë gjithmonë analiza dhe vlerësimi i tregut (tregjeve) përkatës në nivelin e pakicës.
17. AKEP vlerëson nëse tregu/gjet përkatës me pakicë është/janë konkurrues në mungesë të rregullimit të tregut/gjeve me shumicë për sipërmarrësit me FNT (individuale ose të përbashkët), dhe si rezultat identifikimin nëse mungesa e konkurrencës në këtë treg është e qëndrueshme. Në këtë kuadër, AKEP merr në konsideratë kushtet ekzistuese të tregut si edhe pritshmëritë apo parashikimet e zhvillimit të tregut deri në periudhën e ardhshme të rishikimit në mungesë të rregullimit të tregut bazuar fuqi të ndjeshme në këtë treg, kjo metodë njihet si Qasja e modifikuar Greenfield (Modified Greenfield Approach²).
18. Njëkohësisht, analiza duhet të marrë në konsideratë specifikat e tjera të sektorit nën rregullim, vendimet ose legjislacionin që aplikohet në tregjet përkatëse me pakicë dhe shumicë gjatë periudhës së analizuar.
19. Nëse tregu/gjet me pakicë të marra në analizë vlerësohet/n se është/janë në konkurrencë të qëndrueshme vlerësuar nga metoda ‘ Modified Greenfield Approach’, rregullatori duhet të arrijë në përfundimin se rregullimi ‘ex-ante’ nuk është më i nevojshëm për tregun e shumicës.
20. Gjatë proceseve të analizave përkatëse, AKEP do të mbajë në konsideratë të dhënat aktuale dhe ato të periudhave të kaluara që përkojnë me zhvillimin e tregut të marrë në shqyrtim për periudhën përkatëse të rishikimit, lidhur me këtë, do konsiderojë që jo çdo evidencë nga praktikatat e mëparshme sjell automatikisht që qasje e njëjtë duhet të ndiqet edhe për në periudhat e ardhshme të analizës së tregut. Gjithsesi, praktika e kaluar është e përshtatshme nëse karakteristikat e tregut të marrë në analizë nuk kanë ndryshuar në mënyrë të qenësishme apo konsiderohet që nuk do ndryshojnë në periudhën e marrë në analizë.
21. Në vijim të sa më lart, gjatë hartimit të dokumentit të analizës AKEP duhet të marrë në konsideratë situatën aktuale si edhe dinamikat dhe zhvillimet e pritshme në këtë treg në mënyrë që të adresojë shqetësimet apo shtrembërimet e konkurrencës të evidentuara në tregun e shitjes më pakicë duke vendosur masa rregullatore adekuate në tregun respektiv me shumicë, masa të cilat *inter alia*, duhet të nxisin konkurrencën dhe kontribuojnë në zhvillimin e tregut. Analiza duhet të bazohet në funksionimin dhe ndërlidhjen e tregut përkatës me shumicë dhe tregut me pakicë, si edhe me tregje të tjera nëse kjo vlerësohet e nevojshme nga AKEP.
22. Kushtet apo shqetësimet e evidentuara në tregun e shërbimeve të pakicës mund të pajisin AKEP me sinjale për analizimin e tregut të shumicës, por jo domosdoshmërisht këto sinjale mund të sjellin identifikimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në tregun e shumicës. Edhe

² Notat shpjeguese të Rekomandimit të Komisionit 2014/710/EU, SWD(2014)298, fq. 8.

nga praktika e Komisionit Evropian³, vlerësohet se nuk është e nevojshme të provohet ekzistenca e FNT në nivelin e shitjes me pakicë për të konfirmuar se një ose disa sipërmarrës kanë FNT në tregjet përkatëse me shumicë. Bazuar në këto praktika, rregullimi ‘ex-ante’ në nivelin e tregut me shumicë është i mjaftueshëm për të adresuar problemet e konkurrencës në tregjet e rrjedhës së poshtme që lidhen me të.

23. Gjatë analizës së kufijve të tregut dhe fuqisë së tregut brenda tregut përkatës me shumicë, për të vlerësuar nëse ai/ato treg/gje janë me konkurrencë efektive, mbahen në konsideratë të gjitha shqetësimet direkte dhe indirekte që ndikojnë konkurrencën, kjo pa marrë parasysh nëse këto kufizime/shqetësime rrjedhin nga rrjetet e komunikimeve elektronike, shërbimet e komunikimeve elektronike apo lloje të tjera shërbimesh ose aplikacionesh që janë të krahasueshme nga perspektiva e përdoruesit fundor.
24. Në praktikën rregullatore të komunikimeve elektronike, në tregjet në zhvillim, kur de-facto ofruesi kryesor i tregut zotëron pjesë të konsiderueshme të këtij tregu, nuk duhet të jetë objekt i vendosjes së masave rregullatore jo të duhura. Kjo pasi vendosja e masave të pastudiuara për rregullim ex-ante mund të ndikojë kushtet e konkurrencës dhe duke i dhënë formë apo drejtim tjetër tregut në zhvillim. Në të njëjtën kohë, uzurpimi i këtij tregu në zhvillim nga konkurrenti kryesor duhet të shmanget.

3. Kriteret kryesore për përcaktimin e tregut përkatës

25. Vlerësimi nëse një sipërmarrës gëzon FNT “se gëzon pozicion dhe fuqi ekonomike të tillë që i mundëson atij të sillet deri në një masë në mënyrë të pavarura nga konkurrentët e tij, konsumatorët dhe përdoruesit fundorë”, është i një rëndësie thelbësore në përcaktimin e tregut, kjo pasi konkurrenca efektive në treg mund të vlerësohet vetëm duke u bazuar tek ky përcaktim.
26. Procedura e përcaktimit të tregut nuk është proces abstrakt apo mekanik, por kërkon analizimin e të gjitha evidencave të disponueshme sjelljes së aktorëve të tregut në të kaluarën dhe një kuptim gjithëpërfshirës të mekanizmave të sektorit. Në veçanti, nevojitet qasje dinamike përkundrejt asaj statike kur zhvillon një proces analize në perspektivë bazuar në qasjen ‘forward looking’.
27. Pika fillestare e çdo analize duhet të jetë vlerësimi i tregut/gjeve përkatës me pakicë, duke marrë parasysh zëvendësueshmërinë nga ana e kërkesës dhe ofertës nga perspektiva e përdoruesit fundor deri në periudhën e ardhshme të rishikimit duke u bazuar në kushtet ekzistuese të tregut dhe zhvillimin e pritshëm të tyre në të ardhmen. Pasi të jenë identifikuar tregjet përkatëse me pakicë dhe të jetë konstatuar se nëse në mungesë të ndërhyrjes rregullatore në nivelin e shitjes me shumicë, rreziku i dëmtimit të konsumatorit për shkak të mungesës së konkurrencës në tregjet me pakicë do të vazhonte, AKEP duhet të identifikojnë tregjet respektive me shumicë për të vlerësuar nëse ato përlligjen ndaj rregullimit ‘ex-ante’ sipas 89 të ligjit 54/2024. Ata duhet të fillojnë duke identifikuar dhe analizuar tregun me shumicë që ndodhet në rrjedhën e sipërme të tregut në raport me tregun me pakicë ku janë konstatuar probleme të konkurrencës, dhe duke përcaktuar kufijtë e tregut duke marrë parasysh zëvendësueshmërinë nga ana e kërkesës dhe, nëse është e rëndësishme, nga ana e ofertës në lidhje me produktet.

³ Praktikant IE/2004/0121, ES/2005/0330, SI/2009/0913 dhe NL/2015/1727

28. Shkalla në të cilën furnizimi i një produkti ose ofrimi i një shërbimi në një zonë të caktuar gjeografike konsiston në varësinë që ka një treg i caktuar ndaj ekzistencës së presionit konkurrues në sjelljen që ka një ofrues shërbimesh për vendosjen e çmimeve. Ka dy kufizime kryesore konkurruese që duhen marrë parasysh në vlerësimin e sjelljes së sipërmarrësve në një treg përkatës; i) zëvendësimi nga ana e kërkesës; dhe ii) zëvendësimi nga ana e ofertës. Një burim i tretë kufizimi konkurrues në sjelljen e sipërmarrësit që merret në konsideratë jo në fazën e përcaktimit të tregut, por kur vlerësohet nëse një treg është në konkurrencë efektive është ekzistenca e konkurrencës potenciale.
29. AKEP identifikon grupin e produkteve ose shërbimeve që janë të zëvendësueshme nga këndvështrimi i kërkesës dhe ofertës.
30. Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës nënkupton shkallën në të cilën përdoruesit përfundimtarë janë të gatshëm dhe në gjendje të zëvendësojnë një produkt ose shërbim me një tjetër, në rast të ndryshimeve në çmim ose kushte të tjera tregu. Kjo vlerësohet mbi bazën e reagimit të konsumatorëve ndaj ndryshimeve të mundshme të çmimeve dhe karakteristikave të produktit ose shërbimit.
31. Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës nënkupton aftësinë dhe gatishmërinë e operatorëve të tjerë, përveç atyre që aktualisht ofrojnë produktin ose shërbimin në fjalë, për të kaluar në ofrimin e produkteve ose shërbimeve të ngjashme në afat të menjëhershëm ose afatshkurtër, pa hasur kosto shtesë të konsiderueshme.
32. Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës ka rëndësi të veçantë në sektorin e komunikimeve elektronike, pasi e njëjta infrastrukturë rrjeti mund të përdoret për ofrimin e disa llojeve të ndryshme të shërbimeve.
33. Dallimi ndërmjet konkurrencës potenciale dhe zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës qëndron në faktin se zëvendësueshmëria nga ana e ofertës ndodh në mënyrë të menjëhershme pas një rritjeje çmimi, ndërsa hyrja e konkurrentëve potencialë në treg mund të kërkojë një periudhë kohore më të gjatë dhe investime fikse të konsiderueshme.
34. Për këtë arsye, konkurrenca potenciale nuk merret në konsideratë në fazën e përcaktimit të tregut, ndërsa zëvendësueshmëria nga ana e ofertës konsiderohet një element i rëndësishëm në vlerësimin e kufijve të tregut dhe të nivelit të konkurrencës efektive.
35. Zëvendësueshmëria analizohet përmes testeve ekonomike dhe treguesve të tjerë, Testi SSNIP (Small but Significant Non-transitory Increase in Price) ose ndryshe Testi i Monoploistit Hipotetik. Në analizë, përfshihen edhe testet strukturore si:
- përqendrimi i tregut (HHI⁴);
 - barrierat hyrëse;
 - kontrolli mbi infrastrukturën thelbësore;
 - mundësia e ofrimit të të njëjtave shërbimeve nga konkurrentë.
36. Një produkt konsiderohet të përbejë një treg me vete nëse “monopolisti” (hipotetik) që ofron produktin mund të rrisë çmimin e këtij produkti për një periudhë kohe jo tranzitore dhe të mos ketë rënie në shitje deri në nivelin që kjo të jetë jo- fitimprurëse. Pra, rritja e çmimit duhet te

⁴ Herfindahl-Hirschman Index (HHI) mat përqendrimin e tregut dhe përdoret për përcaktimin e konkurrencës në treg.

jete fitimprurëse dhe e qëndrueshme, dhe monopolisti të ketë aftësinë të mbajë çmimin mbi nivelin konkurrues.

37. Testi i monopolistit hipotetik kryhet për të analizuar produktet/shërbimet të cilat mund të bëjnë pjese në të njëjtin treg duke marrë në konsideratë efektin e zëvendësueshmerisë së produkteve në anën e kërkesës dhe/ose ofertës. Nëse monopolisti përballet me kufizime nga ana e kërkesës konsumatorët do të zhvendosen drejt konsumit të një produkti tjetër, që do ishte zëvendësues dhe, nga ana e ofruesve, duke bërë që ofrues të tjerë do të futeshin në këtë treg për të ofruar produktin me çmim dhe përfitim të lartë, atëherë produktet e tjera që janë zëvendësues të ngushtë të produktit të analizuar duhet të përfshihen në këtë treg.
38. Si pikënisje e analizës së tregut, AKEP identifikon fillimisht produktin ose shërbimin e komunikimeve elektronike që ofrohet në një zonë të caktuar gjeografike dhe që mund të jetë objekt i vendosjes së detyrimeve rregullatore ‘ex ante’. Pas identifikimit të tregut përkatës të produktit apo shërbimit fillestar, AKEP mund të përfshijë produkte ose zona shtesë, nëse konstatohet se konkurrenca nga këto elemente ushtron presion në çmimin e produktit ose shërbimit kryesor të tregut përkatës të analizuar. Duke qenë se një rritje relative e çmimit për një grup produktesh mund të nxisë konsumatorët të kalojnë në produkte ose shërbime alternative, çështja thelbësore që duhet vlerësuar është nëse humbja e shitjeve që rezulton nga ky kalim do të ishte e mjaftueshme për të neutralizuar efektet e përfitimit shtesë të operatorit që vijnë si rezultat i rritjes së çmimit. Për të përcaktuar këtë, AKEP duhet të analizojë zëvendësueshmërinë nga ana e kërkesës dhe ofertës, me qëllim matjen e të ashtuquajturës “humbje kritike” të shitjeve (critical loss), që e bën një rritje të çmimit ekonomikisht të jo-fitimprurëse, e cila ndihmon në përcaktimin e tregut përkatës. Testi i zëvendësueshmerisë duhet të zbatohet deri në pikën ku mund të përcaktohet se një rritje relative e çmimit në tregun përkatës gjeografik dhe atë të produktit do të ishte e fitimprurëse, pra nuk do të shkaktonte më humbje të konsiderueshme të shitjeve ndaj produkteve zëvendësuese ose konkurrentëve që veprojnë në zona të tjera.
39. Në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, testi i monopolistit hipotetik aplikohet për produktet ose shërbimet çmimet e të cilave përcaktohen në mënyrë të lirë dhe të cilat nuk janë subjekt i rregullimit. Në rastet e rregullimit ‘ex ante’, ku produktet ose shërbimet ofrohen me çmime të orientuara në kosto dhe janë subjekt i ndërhyrjes rregullatore, supozohet se çmimi i përcaktuar mbi bazën e parimit të orientimit drejt kostos është në nivel konkurrues, ky çmim (i orientuar në kosto) përdoret si pikënisje për vlerësimin e monopolistit hipotetik.
40. Zakonisht, kur produkti apo çmimi i disponueshëm referues i tij nuk njihen, aplikimi i testit SSNIP do të ishte e vështirë për tu aplikuar. Kur nuk ekziston një produkt apo çmim i disponueshëm për referencë, por ekziston mundësia teknike dhe komerciale për ofrimin e tij në rrjet, AKEP duhet të marrë në konsideratë vetë-furnizimin (self-supply) dhe të supozojë një treg hipotetik që përfshin këtë vetë-furnizim, në mënyrë që të përcaktojë tregun përkatës duke konsideruar efektet negative në tregun me pakicë dhe konsumatorët, duke konsideruar se kërkesa potenciale për produktin ose shërbimin ekziston.

4. Përcaktimi i tregut të produktit dhe/ose shërbimit

41. Tregu i produktit përfshin produktet ose shërbimet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tyre, jo vetëm për sa u përket karakteristikave, çmimit apo qëllimit

të përdorimit të tyre, por edhe aspekteve që lidhen me kushtet e konkurrencës në treg dhe/ose strukturën e kërkesë/ofertës në tregun në fjalë. Produktet apo shërbimet që vlerësohen si të zëvendësueshme si rezultat i një ndryshimi të vogël apo në një masë të caktuar nuk bëjnë pjesë në të njëjtin treg përkatës. Pra, AKEP do të ndërmarrë vlerësimin e përcaktimit të tregut përkatës të produktit apo shërbimit duke i grupuar së bashku shërbimet apo produkte që përdoren nga përdoruesit fundor për një qëllim të vetëm (përdorim fundor).

42. Edhe pse qëllimi i përdorimit final të një produkti ose shërbimi lidhet ngushtësisht me karakteristikat e tij fizike, lloje të ndryshme produktesh ose shërbimesh mund të përdoren për të arritur të njëjtin qëllim përfundimtar.
43. Zëvendësueshmëria ndërmjet shërbimeve të ndryshme mund të shkaktohet edhe si rezultat i rritjes dhe konvergjit të teknologjive të ndryshme, të cilat shpesh ju mundësojnë operatorëve të ofrojnë në tregun e pakicës plane tarifore të ngjashme (bundles). Për shembull, përdorimi i sistemeve të digjitalizuar mund të çojë në ngjashmëri në karakteristika apo performancë të shërbimeve të ofruara nga këto rrjete.
44. Për më tepër, shtimi i përdorimit të shërbimeve bazuar në aplikacionet OTT (over-the-top) apo shërbimeve të tjera të komunikimit që bazohen në përdorimin e internetit kanë sjellë shtim të presionit konkurrues duke ndikuar edhe në përcaktimit të shërbimeve të tregut të pakicës për komunikimet elektronike. Si rezultat, AKEP në përcaktimin e tregut do të marrë në konsideratë efektet e këtyre shërbimeve, për të vlerësuar zhvillimet e pritshme të tregut në të ardhmen, duke trajtuar nëse këto shërbime mund të jenë zëvendësues të pjesshëm ose zëvendësues të plotë të shërbimeve tradicionale të komunikimeve elektronike.
45. Si rezultat, përpos konsiderimit të produktit ose shërbimit karakteristikat e të cilit, çmimet dhe qëllimi i përdorimit final i bëjnë ato mjaftueshmërisht të zëvendësueshëm, AKEP duhet të analizojë, kur është e nevojshme, prevalimin e kushteve të kërkesës së tregut, dhe kur është e përshtatshme zëvendësueshmërinë nga ana ofertës nëpërmjet aplikimit të testit të monopolistit hipotetik ose SSNIP për të bërë të mundur përcaktimin final të tregut përkatës në funksion të analizës së tregut.

Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës

46. Zëvendësimi nga ana e kërkesës mundëson përcaktimin e produkteve apo grupit të produkteve që vlerësohen si lehtësisht të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe që mund ti ndërrojnë lehtësisht si reagim ndaj një rritje të vogël, por të konsiderueshme dhe jo të përkohshme të çmimit. Për të vlerësuar ekzistencën e zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës, AKEP duhet të përdorë çdo evidencë të mundshme që dëshmon sjelljen e konsumatorit në të shkuarën si edhe të vlerësojë reagimin e konsumatorëve dhe ofruesve në rast të rritjes së çmimit të produktit ose shërbimit të marrë në shqyrtim.
47. Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës ndodh sepse një rritje e çmimeve e bën një produkt më pak të pëlqyer nga konsumatorët, të cilët vendosin të blejnë më pak nga ai dhe më shumë nga produktet alternative zëvendësuese.
48. Mundësia e konsumatorëve për të ndryshuar përdorimin e një produkti apo të një shërbimi si rezultat i një ndryshimi të vogël, por të konsiderueshëm dhe jo të përkohshëm të çmimit, mund të afektohet nga kostot e mëdha të këtij ndryshimi (kostot e kalimit nga përdorimi i produktit/shërbimit ekzistues në përdorimin e një produkti/shërbimi tjetër). Përdoruesit që kanë investuar në një teknologji specifike ose kanë kryer të gjitha investimet e nevojshme për

të marrë një produkt/shërbim të caktuar, mund të mos duan që të kenë kosto të tjera shtesë që lidhen me ndryshimin e produktit ose shërbimit me një produkt të zëvendësueshëm, duke i vlerësuar këto kosto si të larta. Në përputhje me sa parashtriam, në një situatë kur konsumatori përballlet me kosto të larta të ndërrimit të produktit për të zëvendësuar një produkt/shërbim A me një produkt/shërbim B, atëherë këto dy produkte/shërbime nuk mund të bëjnë pjesë në të njëjtin treg përkatës.

49. Në nivelin e shitjes me pakicë, zhvillimet e vazhdueshme teknologjike kanë sjellë rritje të konkurrencës ndërmjet platformave të ofrimit të rrjeteve, pasi shërbimet e ofruara në nivel pakice janë evidentuar si të barabarta dhe zëvendësueshmëri në rritje⁵. Për të përcaktuar nëse ofrimi i shërbimit me shumicë i ofruara nga rrjete që përdorin teknologji të ndryshme përfshihen në të njëjtin treg përkatës në nivel shumicë duhet të aplikohet testi SSNIP. Duke pasur në fokus rregullimin me perspektivë zhvillimet në të ardhmen ‘forward looking’ që analiza e tregut ka në thelb, vlerësimi duhet të marrë në konsideratë se ofruesit potencialë të aksesit, të cilët ende nuk ofrojnë shërbime të bazuara në akses, nuk përballen me kostot e ndërrimit të teknologjisë (switching costs) në zgjedhjen e rrjetit/teknologjisë së aksesit. Ky vlerësim duhet të marrë në konsideratë rast pas rasti rëndësinë e hyrjeve të reja potenciale, duke mbajtur parasysh se numri i hyrjeve të reja në treg është i vështirë për tu parashikuar.
50. Për më tepër, analiza duhet të zhvillohet mbi bazën e një mjedisi hipotetik konkurrues të aksesit, të mundësuar nga rregullimi përkatës, duke përjashtuar pengesat që nuk janë objektivist të justifikueshme për ndërrimin (switching) e teknologjisë nëpërmjet të cilës merret akses në rrjet.

Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës

51. Në vlerësimin e qëllimit të zëvendësueshmerisë nga ana e ofertës, AKEP mund të marrë në konsideratë se mund të ketë sipërmarrës të cilët aktualisht nuk janë aktivë në tregun përkatës të produktit mund të vendosin të hyjnë në këtë treg brenda një periudhe kohore afatshkurtër, duke u mbështetur në rritjen e vogël dhe të qëndrueshme të çmimit në tregun e analizuar. Afati kohor që do të vlerësohet për vlerësuar reagimin e ofruesve të mundshëm të cilët mund të ndikohen nga një rritje relative e çmimit patjetër që do të varet nga karakteristikat e secilit treg dhe duhet të vlerësohet rast pas rasti. Në rastin kur kostot e ndërrimit të linjës së prodhimit (switching costs) janë relativisht të parëndësishme, atëherë produkti mund të përshihet në përcaktimin e tregut të produktit. Në parim, rregullatorët duhet të sigurohen nëse një ofrues i caktuar do të përdorë ose të ndërrojë asetet e linjës së prodhimit/shërbimit për të bërë të mundur ofrimin e produktit/shërbimit të tregut përkatës (p.sh nëse zhvillimi i kapaciteteve të tij/saj është i angazhuar në terma të marrëveshjeve afatgjata, etj.). Gjithashtu, duhet të merren në konsideratë edhe aspekte të tjera ligjore ose rregullatore të cilat mund të ndikojnë në kohë të caktuar hyrjen në tregun përkatës, si rezultat dekurajimin e ofrimit të zëvendësueshmerisë nga ana e ofertës.

⁵ Në përcaktimin e këtij tregu rregullatorët kanë arritur në përfundimin se shërbimet e ofruara në tregun e pakicës nga rrjetet fikse janë klasifikuar në të njëjtin treg përkatës pavarësisht nënvizimit të rrjetit të transmetimit (p.sh pavarësisht nëse shërbimi me pakicë është ofruar nëpërmjet kabullit koaksial, fibrës apo bakrit), në përgjithësi konstatimi rregullator ka qenë se ofrimi i shërbimit të tregut me pakicë të ofruara nga rrjetet fikse përcaktohet si treg i ndarë nga shërbimi me pakicë i ofruar nga rrjeti mobile.

Zëvendësueshmëria nga ana e zinxhirit të furnizimit

52. Kufijtë e përcaktimit të tregut përkatës mund të zgjerohen me qëllim konsiderimin e produkteve ose zonave gjeografike të cilat edhe pse nuk konsiderohen zëvendësues të drejtpërdrejtë, duhet të përfshihen në përcaktimin e tregut përkatës për shkak të zëvendësueshmërisë nga ana e zinxhirit të furnizimit.
53. Zëvendësueshmëria nga ana e furnizimit mund të demonstrohet me argumentimin se edhe pse produktet A dhe C nuk janë zëvendësues të drejtpërdrejtë, produkti B është zëvendësues për të dy produktet A dhe C, si rezultat edhe produktet A dhe C mund të konsiderohen se i përkasin të njëjtit treg përkatës pasi çmimet e tyre mund të konsiderohen për zëvendësueshmërinë e produktit/shërbimit B. I njëjti arsyetim bëhet edhe për rastin e përcaktimit të tregut gjeografik përkatës. Për të minimizuar riskun e zgjerimit të panevojshëm të përcaktimit të tregut përkatës, gjetjet për zëvendësueshmërinë nga ana e zinxhirit të furnizimit duhet të argumentohen me prova të nevojshme.
54. Kur çmimet për teknologjitë e të shkuarës dhe ato aktuale mund të kushtëzojnë çmimet për gjeneratat e ardhshme teknologjike, ka gjasa se ekziston zëvendësueshmëria nga ana e zinxhirit të furnizimit, e cila do të justifikonte grupimin e të gjitha gjeneratave të teknologjive në të njëjtin treg përkatës të produktit. Për sa kohë, kufizimet e çmimeve të konsideruara do të vlerësohen për gjenerata teknologjishë të ndryshme, në përgjithësi do të konsiderohet se këto teknologji i përkasin të njëjtit treg përkatës.
55. Edhe pse shumica e përdoruesve mund të jetë zhvendosur drejt përdorimit të infrastrukturave me performancë më të lartë, sërish mund të ketë përdorues që vazhdojnë të përdorin këto rrjete duke u bazuar në teknologjitë e trashëguara nga e kaluara. Në këto raste, duhet të adaptohet një qasje rregullatore që shmang krijimin ose vazhdimin e situatave të varësisë së tregut, duke siguruar që përcaktimi i tregjeve përkatëse të mos jetë më i ngushtë se sa kërkohet objektivisht nga analiza e konkurrencës dhe struktura e tregut.

5. Përcaktimi i tregut gjeografik

56. Tregu gjeografik përcaktohet pasi është identifikuar tregu i produktit. Vetëm pasi të jetë përcaktuar edhe tregu gjeografik përkatës, rregullatori mund të ndërmarrë procesin e analizës së tregut dhe vlerësojë konkurrencën në këtë treg.
57. Edhe procesi i përcaktimit të tregut gjeografik përkatës ndjek të njëjta principe si përcaktimi i tregut përkatës të produktit për të vlerësuar zëvendësueshmërinë nga ana e kërkesë/ofertës si rezultat i rritjes relative të çmimit.
58. Bazuar në praktikën e konsoliduar, një treg përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën sipërmarrësit përkatës janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëm homogjene dhe që mund të dallohen nga zona fqinje sepse kushtet e konkurrencës janë vlerësuar dukshëm të ndryshme në këto zona. Zonat në të cilat vlerësohet se kushtet e konkurrencës janë të heterogjene nuk mund të klasifikohen si treg më vete.

59. Për sa i përket përcaktimit të zonës fillestare gjeografike e cila do të vlerësohet, këshillohet⁶ që kjo zonë duhet: a. të ketë madhësi të përshtatshme; b. të jetë e mundur që të reflektohet struktura e rrjetit të të gjithë operatorëve përkatës, dhe c. të ketë kufij të qartë dhe të
60. Nëse evidentohen diferenca midis zonave/rajoneve, por të cilat nuk konsiderohen se janë të mjaftueshme për të përcaktuar treg/gje tjetër gjeografik më vete apo gjetjet për FNT, atëherë duhet të diferencohen edhe masat rregullatore për këto zona gjeografike. Diferencimi dhe qëndrueshmëria, dhe veçanërisht masa në të cilën janë përcaktuar kufijtë e zonës ku vlerësohet konkurrenca duhet të jenë qartësisht të identifikueshme dhe të qëndrueshme (konsistente) gjatë një periudhe kohore përbën thelbin për ndarjen dhe përcaktimin e segmentimit gjeografik të tregut përkatës dhe masave rregullatore respektive.
61. Në sektorin e komunikimeve elektronike përcaktimi i tregut përkatës gjeografik tradicionalisht është bazuar në vlerësimin e dy kriterëve kryesore:
- a. zona e cila mbulohet me rrjet;
 - b. ekzistenca e instrumenteve ligjore dhe rregullatore.

6. Vlerësimi i Fuqisë së Ndjeshme në Treg (FNT)

62. Bazuar në përcaktimet e nenit 88 (2) të ligjit 54/2024, një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm ose së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson sipërmarrësit një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit fundorë të tij.

FNT individuale

63. Vlerësimi i FNT mbështet në një sërë faktorësh dhe kriteresh të cilat janë të përcaktuara në nenin 87 e vijim, të ligjit 54/2024.
64. Për të vlerësuar fuqinë e tregut të një sipërmarrësi është e rëndësishme të mbahen në konsideratë pjesët e tregut të tij dhe pjesët e tregut të konkurrentëve, si edhe kushtëzimet që mund të vijnë nga konkurrentët potencial në periudhë afatshkurtër. Pjesët e tregut shërbejnë si një tregues fillestar i nevojshëm për të vlerësuar strukturën e tregut dhe peshën relative që ka secili prej operatorëve aktivë në treg. Megjithatë, pjesët e tregut duhet të interpretohen nën dritën e vlerësimit edhe të kushteve të tregut përkatës, dhe në veçanti dinamikave dhe zhvillimit të tregut dhe masës me të cilën produktet janë të diferencuara.
65. Bazuar në praktikën rregullatore të komunikimeve elektronike, për rastet kur pjesët e tregut të një sipërmarrësi të vetëm tejkalojnë 50% të pjesëve të tregut përkatës atëherë pjesa e tregut në vetvete është evidencë e fuqisë së ndjeshme. Praktika sugjeron se sa më e lartë të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha kohore që sipërmarrësi e gëzon këtë pozitë, aq më e madhe është mundësia që ky të jetë një tregues i ekzistencës së FNT. Gjithsesi, ka raste kur një sipërmarrës edhe pse zotëron pjesë të lartë tregu mund të mos jetë në gjendje të veprojë në mënyrë të pavarur në masë të konsiderueshme, nëse konsumatorët e tij disponojnë fuqi të mjaftueshme kundërvepruese (bargaining power) për të reaguar ndaj kushtet tregtare ose rritjes së çmimeve nga ana e këtij sipërmarrësi. Si kundër, treguesi se një sipërmarrës gradualisht po

⁶ Shpjegimet shoqëruese të rekomandimit 2014/710/EU, SWD(2014)298.

humbet pjesë të tregut, mund të jetë një indikacion se tregu po bëhet më konkurrues, por kjo nuk përjashton mundësinë e konstatimit të fuqisë së ndjeshme të tij në treg. Ndryshime të konsiderueshme të pjesëve të tregut gjatë një periudhe kohore mund të shërbejnë si një tregues i mungesës së fuqisë së ndjeshme në tregun përkatës. Aftësia e një hyrësi të ri në tregun përkatës Mundësia e rritjes së shpejtët të pjesëve të tregut të një hyrësi të ri në tregun përkatës mund të sugjerojë së tregu përkatës i marrë në analizë është më konkurrues dhe se barrierat e hyrjes mund të tejkalohen brenda një afati të arsyeshëm.

66. Nëse pjesa e tregut të një sipërmarrësi është e lartë, por poshtë kufirit 50%, analiza duhet të mbështetet në vlerësimin edhe të treguesve të tjerë strukturorë për të përcaktuar FNT. Analiza dhe vlerësimi duhet të bëhet duke konsideruar zhvillimin ekonomik dhe karakteristikat e tregut përkatës përpara se të dilet në përfundimin e ekzistencës së FNT në këtë treg.

67. Në vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg, AKEP-i bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a. në madhësinë e sipërmarrësit, madhësinë e sipërmarrësit në raport me tregun përkatës, si edhe me ndryshimet në kohë, në pozicionin relativ të tij, ndaj lojtarëve të tregut;
- b. në pengesat e larta për hyrje në treg dhe zgjerimi i pritshëm, si rrjedhojë e konkurrencës së mundshme;
- c. në fuqinë kundërvepruese të blerësve;
- d. në zhvillimin e elasticitetit ndërmjet kërkesës dhe ofertës;
- e. fazat e zhvillimit të tregut përkatës;
- f. përparësitë teknologjike;
- g. çdo zhvillim i rrjeteve të shitjes dhe shpërndarjes;
- h. ekonomitë e shkallës ose ekonomitë e sektorit dhe dendësisë;
- i. shkallën e integritit vertikal;
- j. shkallën e produkteve të diferencuara;
- k. aksesin në burimet financiare;
- l. kontrollin mbi infrastrukturën që nuk mund të zëvendësohet lehtësisht;
- m. sjelljet e përgjithshme në treg, si tarifet, politikat e marketingut, shërbimet dhe produktet e kufizuara ose vendosja e pengesave

Nëse kriteret e mësipërme vlerësohen të ndara, jo domosdoshmërisht mund të përcaktojnë se në treg ka FNT, këto gjetje duhet të jenë produkt i kombinimit të një sërë faktorësh.

68. Ekzistenca e FNT në treg mbështetet në vlerësimin e lehtësisë për të hyrë në treg. Në tregun e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, barrierat hyrëse zakonisht janë të larta, kjo veçanërisht për shkak të ekzistencës së barrierave teknologjike të tilla si burimet e fundme të spektrit në dispozicion ose kur hyrja në tregun përkatës kërkon investime të shumta dhe planifikimin e kapaciteteve të nevojshme të shtrirë në një periudhë të gjatë kohore, në mënyrë që ky treg të jetë fitimprurës.

69. Megjithatë, barrierat hyrëse në treg mund të mos jenë shumë relevante në tregjet që karakterizohen nga progresi teknologjik i vazhdueshëm, në veçanti si rezultat i daljeve të teknologjive të reja që ju mundësojnë hyrësve të rinj të ofrojnë shërbime me cilësi të diferencuar të cilat mund të sfidojnë sipërmarrësin me FNT. Në tregjet e komunikimeve elektronike, presioni konkurrues mund të vijë si rezultat i inovacionit dhe kërcënimi i konkurrentëve potencialë të cilët aktualisht nuk janë prezent në treg.

70. Për këtë arsye, duhet të merret në konsideratë mundësia se sipërmarrës potencialë të cilët nuk janë aktivë në tregun përkatës, mundet që në një periudhë afatmesme të vendosin të hyjnë në

këtë treg. Sipërmarrësit të cilët në një situatë të rritjes së çmimit, janë në gjendje të ndërrojnë apo të zhvillojnë linjën e tyre të ofrimit të produktit/shërbimit dhe të hyjnë në tregun përkatës, duhet të trajtohen si pjesëmarrës potencial të këtij tregu, kjo edhe nëse ato aktualisht nuk prodhojnë/ofrojnë produktin përkatës apo ofrojnë shërbime relevante.

71. Hyrja në treg ka më shumë gjasa të ndodhë kur një hyrës potencial operon aktualisht në një nga tregjet fqinje ose ofron shërbime të cilat kanë lidhje çka do ti mundësonte të ofronte apo konkurronte në shërbimet përkatëse me pakicë. Aftësia për të arritur shkallën e minimizimit të kostove eficiente të operimit mund të jetë përcaktuese për të vlerësuar nëse hyrja do të ndodhë dhe do të jetë e qëndrueshme.
72. AKEP do të vlerësojë me kujdes dhe të marrë në konsideratë qëllimin, ekonominë e shkallës, efektet në rrjet, dhe rëndësinë e vlerësimit të burimeve të fundme, si edhe kostove të humbura si rezultat i ndryshimit të rrjetit (network roll-out). Gjithashtu, duhet të mbahet në konsideratë nëse fuqia e tregut të operatorit incumbent mund të kërcënohet nga produkte apo shërbime që vijnë nga jashtë tregut përkatës, dhe tregjet e pakicës të ndërlidhura të tilla si ofruesit e shërbimeve OTT shërbimet e të cilave mbështeten në rrjetet e komunikimeve elektronike. Për këto arsye, edhe kur vlerësohet se kërcënimet të cilat vijnë nga produktet apo shërbimet e ofruara në nivelin me pakicë nuk janë të konsiderueshme për të ndikuar në tregun e pakicës, apo nuk janë të konsiderueshme për të ndikuar si një kërcënim për konkurrencën në ofrimin e shërbimeve në nivel shumice (për qëllim të përcaktimit të tregut përkatës), sërish duhet të merren në konsideratë dhe të vlerësohen nëse këto kërcënime ndikojnë në gjatë fazës së përcaktimit të FNT. Për sa kohë, aktualisht, ofruesit e shërbimeve OTT nuk ofrojnë shërbime të aksesit, në përgjithësi vlerësohet se ata nuk ushtrojnë presione konkurruese në tregjet e aksesit.

Fuqia e përbashkët në treg (FNT e përbashkët)

73. Edhe vlerësimi i fuqisë së përbashkët të tregut (Joint SMP) bazohet mbi të njëjtat principe si vlerësimi i FNT individuale. Fuqia dominuese e tregut mund të mbahet nga disa sipërmarrës, të cilët edhe pse nga pikëpamja ligjore dhe ekonomike veprojnë të pavarur nga njëri-tjetri, në disa raste mbështetur në një këndvështrim ekonomik, në një treg të caktuar ata mund ta paraqesin veten apo të veprojnë/sillen si një njësi e përbashkët⁷.
74. Dy ose më shumë sipërmarrës, vlerësohen se kanë një pozitë dominuese të përbashkët, nëse edhe në mungesë të lidhjeve strukturore ose të lidhjeve të tjera ndërmjet tyre, veprojnë në treg në një strukturë dhe mënyrë të tillë, e cila të çon në një sjellje të bashkërenduar, në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit fundorë.
75. Jo domosdoshmërisht duhet të ekzistojë një marrëveshje apo ndonjë lidhje tjetër ligjore për të përcaktuar se dy ose më shumë sipërmarrës duhet të përcaktohen me pozitë dominuese të përbashkët në treg, përcaktimi i një pozite të tillë mund të bazohet edhe në faktorë të tjerë të mundshëm analizimi të cilëve duhet të bëhet mbi vlerësime ekonomike, dhe në veçanti duhet të vlerësohet struktura e tregut përkatës.
76. Pozita dominuese e përbashkët ekziston kur bazuar në këndvështrimin e karakteristikave aktuale të tregut përkatës, secili pjesëmarrës në oligopolin dominues në fjalë, sapo të

⁷ Case C-395/96 P, *Compagnie Maritime Belge* EU:C:2000:132, recitali 35-36

informohet mbi interesin e përbashkët, konsideron të mundur që në këndvështrimin ekonomik (kur bëhet fjalë për përfitim) të sillen në mënyrë të ngjashme në veprimet e tregut duke synuar që të përfitojë nga çmime më të larta se në një treg konkurrues, pa e pasur të nevojshme që të angazhohet në një praktikë apo marrëveshje të caktuar, kjo duke konsideruar që konkurrentët aktualë apo potencialë dhe konsumatorët efektivisht nuk janë në gjendje të reagojnë ndaj një sjellje të tillë.

77. Bazuar në praktikën e konsoliduar rregullatore (Rasti Airtours)⁸, për të përcaktuar pozitën dominuese në një treg, duhet të plotësohen njëkohësisht tre kritere:

- Së pari, çdo anëtar i oligopolit dominues duhet të ketë aftësinë të dijë se si po sillen anëtarët e tjerë, në mënyrë që të monitorojë nëse po ndjekin apo jo një politikë të përbashkët. Nuk mjafton që secili prej tyre të jetë i vetëdijshëm se një sjellje e ndërsjellë në treg është fitimprurëse për të gjithë, por gjithashtu duhet të ketë një mënyrë për të ditur nëse operatorët e tjerë po ndjekin të njëjtën strategji dhe nëse po e mbajnë atë. Prandaj, duhet të ekzistojë një nivel i mjaftueshëm transparence në treg që t'u mundësojë të gjithë anëtarëve të oligopolit dominues të kenë informacion, të saktë dhe në kohë, për mënyrën se si po evoluon sjellja e pjesëmarrësve të tjerë në treg.
- Së dyti, situata e koordinimit të heshtur duhet të jetë e qëndrueshme në kohë, pra duhet të ekzistojë një nxitje për të mos u larguar nga politika e përbashkët në treg. Vetëm nëse të gjithë anëtarët e oligopolit dominues ruajnë një sjellje paralele, të gjithë mund të përfitojnë. Kështu, nocioni i 'reagimit ndëshkues' ndaj sjelljeve që devijojnë nga politika e përbashkët duhet të vlerësohet në këto kushte. Që një situatë e dominimit të përbashkët të jetë i qëndrueshëm, duhet të ekzistojnë mekanizma të mjaftueshëm frenues që garantojnë një nxitje afatgjatë për të mos u larguar nga politika apo sjellja e përbashkët. Kjo nënkupton që secili anëtar i oligopolit dominues duhet të jetë i vetëdijshëm se një veprim agresiv për të rritur pjesën e vet të tregut, do të provokonte reagime të ngjashme nga të tjerët, duke e bërë që ai të mos përfitonte nga një sjellje e tillë.
- Së treti, për të provuar ekzistencën e një pozite dominuese në nivelin e kërkuar ligjor, duhet gjithashtu të vërtetohet se reagimi i konkurrentëve aktualë dhe potencialë të ardhshëm, si edhe i konsumatorëve, nuk do të rrezikonte rezultatet e pritshme nga politika dhe sjellja e përbashkët e pjesëmarrësve të pozitës dominuese të përbashkët.

78. Përkundrejt kësaj paraqitje, gjatë vlerësimit nëse dy apo më shumë sipërmarrës kanë pozitë dominuese të përbashkët, në funksion të vlerësimit dhe vendosjes detyrimeve rregullatore 'ex-ante' ndaj tyre, rregullatori duhet të ndërmarr një analizë për të vlerësuar nëse ka gjasa që të ndodhin ndryshime deri në periudhën e ardhshme të rishikimit të këtij tregu. Duhet të konsiderohet, nëse pas të gjithë elementëve të marrë në shqyrtim, se kushtet e tregut janë të tilla që mund të lehtësojnë një mekanizëm koordinimi të heshtur, vlerësim i cili duhet të bazohet në rezultatet e testit të kritereve sa më sipër.

79. Zhvillimi i një analize *forward looking*, duhet të marrë në konsideratë zhvillimet e pritura ose që parashikohet të ndodhin në treg gjatë periudhës deri në fazën e ardhshme të rishikimit, për të vlerësuar nëse në treg mund të ekzistojë një marrëveshje e heshtur. Niveli i përmbushjes së kritereve sa më sipër, duhet të konsiderojë strukturën e tregut si edhe çdo evidencë tjetër të

⁸ Rasti Airtours (Shiko Udhëzimet e KE për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT bazuar në EECC)

disponueshme të sjelljes së tregut, të cilat mund të krijojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e një mekanizmi koordinimi hipotetik dhe arrijen e një marrëveshje të heshtur.

80. Vlerësimi i evidentimit të mundësisë së ekzistencës së koordinimit të heshtur, duhet të bazohet në mekanizma që mbështeten mbi prova dhe të dhënat e disponueshme, si edhe duke marrë në konsideratë supozime hipotetike. Pra duhet të shmanget përdorimi i një praktikë në formë *'check liste'*, pra plotësimi i pikave të paracaktuara.
81. Në ngjashmëri me legjislacionin e konkurrencës për rastet e bashkimit të ndërmarrjeve (mergers), për të realizuar analizën e tregut mbi perspektivën e zhvillimeve në të ardhmen duhet të shqyrtohet i gjithë informacioni lidhur me karakteristikat e tregut objekt analize, duke përfshirë si vlerësimin e elementëve strukturorë, ashtu edhe ato që disponohen mbi sjelljen e pjesëmarrësve të tregut në të kaluarën.
82. Mund të arrihet në vlerësim të pranuar gjerësisht, se sjellja e koordinuar është zakonisht më e lehtë të ndodhë në mjedise tregjesh më pak kompleks dhe më të qëndrueshme. Kjo duke mbajtur në konsideratë, se koordinimi i heshtur është zakonisht më i thjeshtë ndërmjet një numri më të vogël lojtarësh tregu, pra është mjaft e rëndësishme të konsiderohet numri i pjesëmarrësve në treg në shqyrtim. Për më tepër, mund të jetë më e lehtë të arrihet në një qëndrim të përbashkët për vlerësimin e dyshimeve të sjelljes së koordinuar nëse shikohet një qasje e ngjashme/simetrike veçanërisht në aspekte të strukturës së tregut, pjesëve të tregut, treguesve të mbulimit, masës apo nivelit të integritetit vertikal dhe kapaciteteve për të replikuar paketat e produkteve të ofruara.
83. Supozohet se transparencja e çmimeve është më e lehtë për tu vlerësuar në tregjet e shitjes në masë të shërbimeve me pakicë, ku homogjeniteti i produkteve/shërbimeve mund të rrisë nivelin e transparencës, por edhe kompleksiteti i vlerësimit të çmimeve të produkteve në nivel pakice mund të reduktohet duke i vendosur rregulla më të thjeshta për përcaktimin e produktit, si për shembull, përcaktimi i grupi përfaqësues të produkteve/shërbimeve. Në tregun e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike ku zakonisht penetrimi i shërbimeve të ofruara nga rrjetet fikse dhe ato mobile tenton drejt mbulimit tërësor të tregut, luhatshmëria nga ana e kërkesës tenton të jetë e vogël, ndaj rritja e numrit të pajtimtarëve mund të kërkohej nga konkurrentët në treg, dhe kjo gjë do të ndikonte në rritjen e transparencës për pjesët e tregut.
84. Gjatë procesit të vlerësimit të të dhënave aktuale dhe vlerësimit për zhvillimet e mundshme në të ardhmen, AKEP duhet të ndjekë qasjen *'Modified Greenfield Approach'* të cituar sa më sipër (koresponduesi i pg 17 të udhëzuesit), sipas së cilës duhet të përjashtohen efektet që vijnë nga rregullimi aktual për një sipërmarrës të përcaktuar me FNT.
85. Evidencat aktuale të disponueshme nga rregullatorët për tregje që i nënshtrohen rregullimit gjatë kohës kur kryhet analiza mund të jenë të ndryshme nga të evidencat/treguesit e tregjeve të cilat nuk janë nën rregullim. Megjithatë, rregullatori duhet të jetë në gjendje të paraqesë evidenca të strukturës dhe sjelljes së tregut, siç mund të jetë rasti kur masat rregullatore të vendosura që janë në fuqi, mund të mos i kenë adresuar tërësisht dështimet e evidentuara në treg. Kjo nuk nënkupton se standardi i provës duhet të jetë më i ulët, apo që mekanizmi hipotetik për evidentimin e koordinimit të fshehur duhet të jetë i ndryshëm.
86. Gjatë vlerësimit për ekzistencën e FNT të përbashkët dhe vendosjen e masave rregullatore përkatëse *'ex-ante'*, duhet të mbahen në konsideratë të gjitha rrethanat e tregut për të arritur në konkluzionin se në treg, në të ardhmen mund të ndodhë një marrëveshje apo një sjellje e

koordinuar në heshtje si rezultat i mungesës së vendosjes masave rregullatore ‘ex-ante’, konsideruar kjo nëse **i)** këto rrethana janë në koherencë me praktikën ekonomike për evidentimin e koordinimit të heshtur të zhvilluar nga rregullatori dhe **ii)** gjatë vlerësimit, është konstatuar se janë të nevojshme për arsyetuar se tregu përlligj hipotezën e sjelljes dhe koordinimin e heshtur, e bazuar kjo nga përfshirja dhe analiza e kryer mbi bazën e tre kritereve rasti *Airtours* dhe të plotësuar me praktikën e përcaktuar në paragrafin 76.

87. Analiza për përcaktimin e FNT të përbashkët duhet të marrë në konsideratë specifikat e sektorit të komunikimeve elektronike, veçanërisht faktin e lidhjeve së ndërsjellët që ekziston midis tregjeve të shumicës dhe pakicës, mekanizimi për vlerësimin ekonomik të koordinimit në heshtje nuk është i limituar vetëm në nivelin e shitjes me shumicë që do të vlerësohen, por duhet të marrë në konsideratë edhe ndërveprimin në të dyja nivelet. Në këtë kuadër, fokusi duhet të jetë në njërin nga tregjet atë të pakicës ose të shumicës dhe veprimet duhet të ndërmerren me mënyrën e funksionimit me tregun e ndërlidhur në shumicë ose të rrjedhës së poshtme (pakicës), si edhe tregjet e tjera me pakicë të ndërlidhura, ose edhe në tregjet e jashtme nëse oligopolisti është prezent dhe vepron në ato tregje.
88. Bazuar në praktikën rregullatore, përpos mekanizmit të transparencës, një strukturë tregu mund të mundësojë krijimin e një marrëveshje të heshtur nëse tregu karakterizohet nga një përqendrim i lartë dhe homogjenitet i produkteve. Karakteristika të tjerë që mund të çojnë në një konkluzion të ngjashëm bazohen në rastet e praktikave ligjore apo vendimmarrjeve rregullatore në të shkuarën. Një listë me indikatorë jo-shterues që AKEP mund të konsiderojë gjatë vlerësimeve rast pas rasti, mund të bazohet në shembuj, pjesët e tregut, elasticiteti i kërkesës, shkalla e integritimit vertikal, ngjashmëritë në kosto dhe kapacitetet e prodhimit, rrjeti i shpërndarjes, përfitimi dhe treguesi ARPU (e ardhura mesatare për përdorues), një shkallë relative simetrie ndërmjet operatorëve, si edhe ngjashmëri në aktivitetet dhe ofertat e tyre me pakicë. Megjithatë, vlerësimi vetëm nëpërmjet një liste shteruese nuk është i sugjeruar. Për më tepër, lidhja ndërmjet këtyre treguesve duhet të trajtohet dhe vlerësohet në situata të caktuara rast pas rasti, dhe duhet të merren në konsideratë edhe karakteristikat dhe rrethanat kombëtare. Nëse AKEP do të bazohet në vlerësimin e parametrave duke u mbështetur në praktikën rregullatore të bazuar në ligjin e konkurrencës për vlerësimin *ex-post*, atëherë duhet të merren në konsideratë edhe specifikat e vlerësimit *ex-ante* të përcaktuara në legjislacionin e komunikimeve elektronike, me qëllim identifikimin e rrethanave specifike, dhe duke konsideruar nëse këto rrethana/karakteristika të tregut përkatës janë të tilla që secili anëtar i oligopolit dominues (joint oligopoly) e konsideron të mundur nga pikëpamja ekonomike dhe si rezultat të preferueshme për të adoptuar një politikë sjellje të përbashkët afatgjatë në tregun e marrë në shqyrtim.

Transparenca

89. Siç u evidentua edhe më sipër, pikënisja për identifikimin e FNT të përbashkët është krijimi i një politike të përbashkët për të mundësuar një sjellje të ngjashme në të ardhmen.
90. Gjatë vlerësimit për të evidentuar nëse një treg është mjaftueshëm transparent për të mundësuar krijimin e një marrëveshje të heshtur, duhet të analizohet nëse pjesëmarrësit kanë interesa dhe nxitje për të shkuar drejt një sjellje të koordinuar të identifikueshme, duke hequr dorë në këtë mënyrë nga mbështetja në sjellje të bazuar në konkurrencë të lirë. Ky është rasti kur përfitimet afatgjata të bazuar mbi sjelljen antikonkurruese i tejkalojnë përfitimet afatshkurtra të cilat

bazohen në konkurrencën në treg. Siç nënvizohet në paragrafin 88 më sipër, përfshirja dhe mbajtja e një marrëveshje të heshtur është e ndërvarur nga një sërë karakteristikash të tregut, të cilat mund ta bëjnë një treg të caktuar më të predispozuar të shkoj drejt një marrëveshje të tillë.

91. Në rrethanat specifike të tregjeve të komunikimeve elektronike, të cilat karakterizohen nga barriera të larta për hyrje dhe kosto të larta të pakthyeshme, hyrësit e rinj e kanë të nevojshme rritjen e pjesës së tregut për t'ju mundësuar rikuperimin e kostove dhe realizmin e fitimeve. kanë nxitje për të rritur pjesën e tyre të tregut për të siguruar rikuperimin e kostove. Nga ana tjetër, simetria e pjesës së tregut nuk përbën domosdoshmërisht nxitje për të shkuar drejt një marrëveshje të heshtur, për sa kohë është arritur një pjesë tregu e konsiderueshme ose strukturat e kostove të hyrësit të ri janë të krahasueshme ato të pjesëmarrësve të tjerë ekzistues në treg.
92. Në kontekstin e vlerësimit të ekzistencës së fuqisë së përbashkët të konsiderueshme në treg dhe pa paragjykuar kriteret e përshkruara në paragrafin më sipër, një përafrim i ngushtë i çmimeve për një periudhë të gjatë, veçanërisht nëse ato janë mbi nivelin konkurrues, së bashku me faktorë të tjerë tipikë të një pozite të përbashkët dominuese, mund (në mungesë të një shpjegimi alternativ të arsyeshëm) të mjaftojë për të demonstruar ekzistencën e një pozite të përbashkët dominuese, edhe kur nuk ka prova të drejtpërdrejta të forta për evidentuar transparencë të lartë të tregut, pasi një transparencë e tillë mund të merret e mirëqenë në këto rrethana. Hetimi i këtyre rrethanave duhet të kryhet me kujdes dhe mbi të gjitha, duhet të ndjekë një qasje të bazuar në analizën e strategjive të mundshme të koordinimit që mund të ekzistojnë në ato kushte. Në veçanti, për qëllimet e rregullimit ex-ante në sektorin e komunikimeve elektronike, një konstatim i koordinimit të parashtruar më sipër nuk është parakusht, por mund të jetë i rëndësishëm sidomos nëse karakteristikat e tregut nuk kanë ndryshuar në mënyrë të ndjeshme dhe/ose ka pak gjasa të ndryshojnë gjatë periudhës së ardhshme të rishikimit.
93. Nëse sjellja në të kaluarën ndikon në vlerësimin e zhvillimeve të pritshme të tregut në të ardhmen (deri në ndërmarrjen e rishikimit të ardhshëm), AKEP do të mbajë në konsideratë se edhe në prezencë të masave rregullatore, vendosja e detyrimit për kontroll të çmimeve për aksesin e produkteve në nivelin e shumicës mund të mos jetë shpjegim i mjaftueshëm për të argumentuar vrojtimit/dyshimet për koordinim të çmimeve gjatë një periudhe të gjatë kohore në tregun e pakicës. Një sjellje koordinuese e tillë, nëse nuk ka shpjegime të tjera argumentuese, kur ekzistojnë edhe faktorë të tjerë që provojnë ekzistencën e pozitës dominuese kolektive, mund të jetë tregues i një sjellje të ndaluar të koordinimit në heshtje.
94. Përpos detyrimeve rregullatore për përcaktimin e nivelit të çmimeve, shpjegime të tjera të arsyeshme, mund të jenë ato të natyrës ekonomike, p.sh. niveli i caktuar i çmimit është i justifikuar nga pikëpamja e vlerësimit të strukturës së kostove në një treg konkurrues.
95. Për më tepër, në funksion të vlerësimit të kriterit të transparencës, duke konsideruar rrethanat e veçanta të rregullimit ex-ante në tregjet e komunikimeve elektronike, në të cilat barrierat hyrëse vlerësohen si të larta, refuzimi nga ana zotëruesve të rrjeteve për të dhëna akses në terma të arsyeshme mund të shërbejë si një faktor i rëndësishëm për vlerësimin e evidencës së një politike të përbashkët nga oligopolistët dominant. Një refuzim i tillë nga ana e operatorëve të rrjeteve mund të shërbejë si sinjal i ekzistencës së një politike të përbashkët, e cila duhet të merret në konsideratë së bashku me një sërë faktorësh të tjerë gjatë analizës për FNT të përbashkët. Vlerësimi i bazuar në refuzimin e aksesit mund të evidentohet në rastet kur operatorët nuk janë subjekt i rregullimit ex-ante për masa rregullatore për akses, ose të

parashikohet për rastet kur operatorët janë subjekt i detyrimeve për akses gjatë kohës së zhvillimit të analizës, duke konsideruar se janë plotësuar edhe disa kushte të caktuara. Kushte të tilla mund të përfshijnë nxitjen e këtyre operatorëve për të mbajtur norma të larta dhe jo-normale përfitimi në rrjedhën e poshtme apo në tregjet e lidhura të pakicës, të cilat AKEP mbi bazat e analizave të kryera i vlerëson se nuk reflektojnë proporcionin e investimeve të kryera dhe rreziqet e marra përsipër, ose lloje të tjera politikash të përbashkëta jo-të-lidhura me çmimet në një treg që nxit koordinimin e heshtur, pra në kundërshtim me praktikatat e një tregu që funksionon në konkurrencë siç është përcaktuar në praktikatat ligjore të konsoliduara, të cilat mund të shërbejnë si provë se refuzimi i aksesit përbën një pikë fokale të besueshme. Gjithashtu, është e nevojshme që të vlerësohet nëse operatori i marrë në shqyrtim ka mjaftueshmërisht argumente që justifikojnë ofrimin e shërbimit me shumicë për palët e treta.

Qëndrueshmëria

96. Për të mundësuar qëndrueshmërinë në kohë të politikës së përbashkët, duhet të ekzistojë një nxitje që secili anëtar i oligopolit të mos largohet nga termat e koordinimit. Kjo rrjedh nga fakti se anëtarët e oligopolit dominues përfitojnë nga marrëveshja e heshtur vetëm nëse të gjithë mbajnë sjelljen e njëjtë. Ekzistenca e një kërcënimi të besueshëm të kundërpërgjigjes, që dekurajon devijimin, është një kërkesë e domosdoshme për të siguruar që mekanizmi i koordinimit të mbetet i besueshëm me kalimin e kohës.
97. Sa i përket nevojës për t'iu drejtuar aplikimit të një sanksioni, praktika gjyqësore ka argumentuar se vetë ekzistenca e një mekanizmi efektiv dekurajues për të devijuar nga sjellja e përbashkët parimisht është e mjaftueshme, pasi nëse anëtarët e oligopolit i qëndrojnë politikës së përbashkët, nuk ka nevojë të ndërmerren masa apo vendosen sanksione. Mekanizmi më efektiv dekurajues është ai që nuk duhet të devijohet nga politika e sjelljes së koordinuar.
98. Sqarimi sa më lart mund të shpjegohet më mirë me shembull konkret, në rast se AKEP e konsideron pikënisjen e argumentimit të marrëveshjes së heshtur (ndaluar) në refuzim të vazhdueshëm në nivelin e aksesit me shumicë, ku transaksionet në nivel shumice janë të limituara. Në këto raste, AKEP nuk ka nevojë të vërtetojë se përshkallëzimi i kësaj sjellje mund të çojë në një marrëveshje tjetër aksesit me një operatorë tjetër i cili është pjesë e marrëveshjes së ndaluar, por mund të identifikojë ndonjë mekanizëm tjetër të besueshëm për refuzuesin e aksesit ose për tregjet e lidhura të pakicës (të tilla si çmimet agresive në periudha afatshkurtër). Konsideratat e lidhura me portabilitetin dhe largimin e abonentëve, në rrethanat specifike do të mund të mbështesin më tej supozimin mbi ndjeshmërinë e konsumatorëve ndaj ndryshimeve të çmimeve dhe do t'i ndihmonin AKEP-it të parashikojë më mirë gjasat që masat e kundërpërgjigjes në nivel me pakicë të jenë efektive.
99. Besueshmëria e një kërcënimi nëpërmjet vendosjes së sanksioneve dhe/ose zbatimi të tyre duhet të trajtohet nga AKEP rast pas rasti gjatë analizës.

Faktorë të jashtëm

100. Vlerësimi i faktorëve kundërveprues ndaj teorisë së bashkërendimit të heshtur (marrëveshje e ndaluar) duhet të mbajë në konsideratë parimet ekonomike që lidhen me faktin nëse operatorët aktualisht të pranishëm në treg, të cilët nuk janë pjesë e oligopolit që bashkërendon në mënyrë të heshtur sjellje të ndaluar, veprojnë si konkurrentë të vegjël apo kanë potencialin të

shndërrohen në konkurrentë agresivë dhe të prishin ekuilibrin e marrëveshjes së ndaluar, si dhe nëse klientët gëzojnë fuqi të mjaftueshme kundërveprimi për të vënë në rrezik mekanizmin bashkërendues.

101. Në kuadrin rregullator 'ex-ante' të aplikuar në sektorin e komunikimeve elektronike, pozita dhe fuqia e konkurrentëve në treg mund të vlerësohet duke u bazuar në një sërë faktorësh, të cilat lidhen me barrierat e hyrjes së konkurrentëve potencialë, situatën e konkurrencës si edhe barrierat për zgjerim të mëtejshëm të pjesëmarrësve aktual të tregut.
102. Kriteret përkatëse në këtë vlerësim do të përfshijnë: pjesën e tregut në tregun që po analizohet, ekonomitë e shkallës dhe gamën e produkteve, potencialin për të ofruar të gjitha produktet e kërkuara nga klientët në nivel me pakicë, fuqinë relative në aktivitetet kryesore të tregut, ekzistencën e konkurrentëve me pjesë të vogël të tregut ose konkurrentëve që operojnë në mënyrë agresive, etj. Në këtë këndvështrim, AKEP duhet të përfshijë në masat paraprake një vlerësim nëse konkurrentët me pjesë të vogla (jashtë marrëveshjes) kanë apo jo aftësinë për të reaguar në këtë treg dhe për të ndikuar në prishjen e marrëveshjes antikonkurruese të koordinuar në heshtje nga një grup dominues sipërmarrësish.
103. Siç e kemi cituar edhe në paragrafin 68 më sipër, tregjet e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike karakterizohen nga barriera të larta hyrjeje, veçanërisht të natyrës ekonomike, pasi ndërtimi i rrjeteve, në mungesë të marrëveshjeve me shumicë për akses, është i kushtueshëm dhe kërkon kohë; si dhe barriera ligjore, pasi politika e spektrit, në veçanti, mund të kufizojë numrin e operatorëve të rrjeteve celulare. Për këto arsye, një hyrës i ri hipotetik që mund të prishë ekuilibrin e bashkërendimit të heshtur, me shumë gjasa do të duhet të mbështetet, të paktën pjesërisht, mbi infrastrukturën e të tjerëve. Në mungesë të ndërhyrjes rregullatore, marrëveshjeve të qëndrueshme tregtare ose inovacionit teknologjik që sjell ndërprerje të ekuilibrit (koordinimit të heshtur), zakonisht gjasat për një hyrje të tillë që të prishë sjelljen e koordinuar në heshtje janë përgjithësisht të ulëta në periudhat afatshkurtra dhe afatmesme.
104. Sa i përket konsumatorëve, në tregjet e mëdha ku numri i konsumatorëve është i lartë, fuqia individuale e tyre për kundërveprim ndaj blerësve nuk është shumë domethënëse. Sikundër, kategoria e përdoruesve biznes të cilët blejnë produkte apo shërbime mbi baza tregtare apo produktet të personalizuar mund të jenë në gjendje që të shfaqin fuqinë e tyre kundërvepruese ndaj blerësve, si rezultat, nëse konsiderohet e përshtatshme fuqia e tyre reaguese mund të analizohet për tregje specifike.

ANEKSI II- LISTA E TREGJEVE PËR NDËRHYRJE EX-ANTE – PËRMBLEDHJE E ARSYETUAR

Qëllimi dhe baza ligjore

Bazuar në procedurën metodologjike dhe arsyetimin për përcaktimin e tregjeve përkatëse të komunikimeve elektronike që mund të jenë objekt ndërhyrjeje rregullatore ex-ante nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në ushtrim të kompetencave të përcaktuara në nenet 87, 89 dhe 90 të Ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike”, si dhe në përputhje me Rekomandimin e Komisionit Evropian (EU) 2020/2245, tregjet përkatëse vlerësohen mbi nevojën e ndërhyrjes rregullatore ex-ante.

Qëllimi i paraprak është:

- të sigurojë identifikimin e tregjeve në të cilat konkurrenca vlerësohet se nuk është efektive ose nuk pritët të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme pa ndërhyrje rregullatore;
- të garantojë që ndërhyrjet *ex-ante* të jenë proporcionale dhe të justifikuara në bazë të strukturës dhe zhvillimeve të pritshme të tregut.

AKEP në përputhje me nenet 87 dhe 89 dhe 90 të Ligjit nr. 54/2024 dhe Rekomandimit të Komisionit Evropian (EU) 2020/2245 për tregjet e rregulluara ‘ex-ante’, ka referuar si tregje të mundshme për ndërhyrje ‘ex-ante’ në territorin e Republikës së Shqipërisë tregjet e mëposhtme me shumicë:

1. Tregu me shumicë i aksesit në një vendndodhje fikse;
2. Tregu me shumicë i aksesit në kapacitete të dedikuara;
3. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të telefonisë fikse;
4. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të telefonisë së lëvizshme.

Lista e tregjeve të propozuara për rregullim ex-ante nga AKEP në ndryshim nga ajo e miratuar nga Komisioni Evropian me rekomandimin (EU) 2020/2245 (i cili përmban vetëm dy tregjet e para), përmban edhe dy tregjet e terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile dhe ato të telefonisë fikse.

Praktika e rregullimit të tarifave të terminimit në vendet e BE-së

Komisioni Evropian nëpërmjet rekomandimit (EU) 2020/2245 mbi tregjet dhe produktet e komunikimeve elektronike për të cilat ka nevojë rregullim ex-ante, ka arritur në përfundimin se lista e tregjeve të nevojshme për rregullim do të jetë vetëm për tregjet broadband fikse:

- *Market 1: Tregu me shumicë të aksesit lokal në infrastrukturën e rrjeteve fizike nga vendndodhje fikse;*
- *Market 2: Tregu me shumicë për kapacitet të dedikuar.*

Lista e tregjeve të parashikuara për rregullim ex-ante në vendet e BE, të cilën e merr në konsideratë edhe AKEP gjatë përcaktimeve të tregjeve për rregullim ex-ante, ka ndryshuar dhe ka ardhur në reduktim. Në rekomandimin e vitit 2014, numri i tregjeve të dyshuar për ndërhyrje *ex-ante* është reduktuar në 5, nga 7 që ishte në vitin 2007, dhe në vitin 2020 nga kjo listë kanë mbetur vetëm dy tregje.

Lista tregjeve nën rregullim 2007	Lista tregjeve nën rregullim 2014	Lista tregjeve nën rregullim 2020
Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse (3)	Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse (1) i pandryshuar	Hequr nga lista
Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile (7)	Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile (2) i pandryshuar	Hequr nga lista
Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike nga vendndodhje fikse (4)	Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike nga vendndodhje fikse WLA (3a) rishikuar	Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike nga vendndodhje fikse WLA (3a) rishikuar
Tregun me shumicë të aksesit broadband (5)	Tregun me shumicë të aksesit broadband WCA (3b) rishikuar	Hequr nga lista
Tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qera (6)	Tregun me shumicë të aksesit me shpejtësi të lartë nga vendndodhje fikse (4) rishikuar	Tregu me shumicë të dedikuar nga vendndodhje fikse
Tregun me pakicë të aksesit në rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse (1)	Hequr nga lista	Hequr nga lista
Tregun me shumicë të origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik (2)	Hequr nga lista	Hequr nga lista

Në përputhje me parashikimet e nenit 75 të Kodit të Komunikimeve Elektronike Evropiane⁹ (EECC) Komisioni Evropian, duke marrë në konsideratë opinionin e BEREC, në përputhje edhe me parashikimet e nenit 117 të EECC, Komisioni ka adaptuar një akt për të mbështetur këtë direktivë për vendosjen e një tarife të vetme maksimale për secilin nga shërbimet e terminimit të thirrjeve zanore nga rrjetet fikse dhe ato mobile, të cilat do të vendosen në të gjithë ofruesit e këtyre shërbimeve në të gjitha vendet anëtare të BE-së.

Kostot e llogaritura për shërbimet e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse dhe ato celulare janë hartuar në përputhje me parimet e metodologjisë së kostove Pure LRIC, duke bërë të mundur evidentimin e kostove të këtyre shërbimeve vetëm për ofrimin e këtij shërbimi duke hequr kostot e tjera të përbashkëta.

Në përputhje me parashikimet e mësipërme, KE ka miratuar Rregulloren (Delegatet Regulation) 2021/654, datë 18.12.2020 “Mbështetje e Direktivës (EU) 2018/1972”. Kjo rregullore, ndër të tjera përcakton detyrimin për aplikimin e një tarife të vetme për terminimin e thirrjeve celulare (MTR) dhe një tarife të vetme për terminimin e thirrjeve nga rrjetet fikse (FTR) dhe do të jenë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjitha vendet e unionit. Sipas kësaj rregulloreje tarifa e terminimit të thirrjeve mobile brenda BE-së do të jetë 0,2 eurocent për minutë, ndërsa tarifa e terminimit të thirrjeve të telefonisë fikse do të jetë 0,07 eurocent për minutë. Tarifat e mësipërme janë të aplikueshme si për terminimin kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar brenda vendeve të unionit.

Rregullorja e KE 2021/654, lidhur me thirrjet e origjinuara nga vendet e tjera dhe të terminuara në vendet e unionit apo anasjelltas thirrjet e origjinuara nga vendet e unionit dhe të terminuara në vendet e tjera, ofron dy skenarë, të cilët bazohen në parimet e reciprocitetit.

- a. Tarifat e rregulluara aplikohen gjithashtu për thirrjet e origjinuara nga një numër i një vendi te trete (jashtë EU) dhe të terminuara në një numër të një vendi anëtar të unionit kur plotësohet një nga dy kushtet si me poshtë:
 1. Ku ofruesi i shërbimit të terminimit të thirrjeve në një vend të trete aplikon për thirrjet e origjinuara nga numrat e vendeve të BE-së, tarifa të terminimit celular ose fikse të njëjta ose

me te ulëta se tarifat maksimale te terminimit te përcaktuara në këtë rregullore, për secilin vit dhe çdo vend anëtar, mbi bazën e tarifave te aplikuara ose propozuara nga ofruesit e shërbimit te terminimit ne vendet e treta kundrejt ofruesve/operatorëve te shërbimit te terminimit ne BE; ose:

2. Kur Komisioni përcakton se, mbi bazën e informacionit te ofruar nga një vend i trete, tarifat e terminimit te zërit për thirrjet e origjinuara nga numrat ne BE dhe te terminuara drejt numrave te vendeve te treta (jo anëtare) janë te rregulluara ne përputhje me parimet ekuivalente me ato te përcaktuara ne nenin 75 te Direktivës BE-se 2018/1972 dhe Aneksi III i saj; dhe që vendi i trete (jo ne BE) është i listuar ne këtë Aneks.
- b. Për thirrjet e origjinuara nga numrat e operatorëve të vendeve të treta (jashtë unionit) dhe të terminuara në një nga numrat e operatorëve të vendeve të unionit ose anasjelltas, nëse operatori i vendit të tretë aplikon tarifa të terminimit më të larta se tarifat e unionit ‘Single maximum Union-wide voice termination rates’ ose kur këto tarifa nuk janë rregulluar në përputhje me parimet e kostove të operatorit eficient të cilat janë ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 75 dhe Aneksin 3 të EECC, atëherë këto thirrje janë të përjashtuara nga qëllimi i rregullimit të kësaj rregulloreje.

Praktika e rregullimit të tarifave të terminimit në Shqipëri

Bazuar në procesin e fundit të analizës së terminimit të thirrjeve mobile të miratuar me vendimin nr. 4, datë 16.2.2024, Këshilli Drejtues i AKEP miratoi dokumentin “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare) – Dokument Përfundimtar”.

MTR për sipërmarrësit e përcaktuar me FNT është bazuar në përshkallëzimin e tarifave² nëpërmjet *glide path*, kjo në zbatim të rezultateve të modelit të kostove miratuar me VKD nr. 10, datë 22.7.2021. Tarifa e vendosur prej 1.02 lekë u aplikua nga operatorët në 1 tetor 2024, ndërkohë që në vitin 2025 do të aplikohen tarifat 0.89 lekë në datën 1 prill, dhe 0.75 lekë në datën 1 tetor 2025.

Ndërkohë, për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë fikse të miratuar me VKD nr.19, datë 03.11.2025, është miratuar rregullimi i përshkallëzuar i tarifave duke përdorur modelin benchmark dhe si referencë u morr eurotarifa e terminimit të thirrjeve nga në rrjetet e telefonisë fikse.

Në të dyja proceset e analizave të tregjeve të terminimit (celulare dhe fikse), rregullimi i tarifave aplikohet vetëm për tregun kombëtar.

Neni 100 i ligjit 54/2024, në pikën 2 të tij, përcakton se tarifat e terminimit të orientuara drejt kostos duhet të demonstrojnë se tarifat e shërbimeve të ofruara rrjedhin nga kosto eficiente dhe mbajnë në konsideratë parashikimet rregullatore të këtij ligji, si edhe praktikatat e rekomandimet e Bashkimit Evropian.

Pas një procesi analize për rregullimin e tarifave, AKEP-i vlerëson të dhënat më të fundit për sa vijon:

- a. tarifat mesatare të vendeve të Bashkimit Evropian;
- b. praktikatat dhe rekomandimet më të mira në vendet e Bashkimit Evropian;
- c. tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë;

- d. raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;
- e. normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e Bashkimit Evropian dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.

Duke qenë se aktualisht tarifat e terminimit të thirrjeve në Shqipëri janë më të larta se eurotarifat të aplikuara në vendet e unionit, tarifa të cilat janë të vlerësuara dhe orientuara drejt kostos, nevojitet që AKEP edhe për shkak të rrethanave kombëtare ti mbaj nën rregullim këto tregje deri në një vendimmarrje finale kur tarifat e terminimit dhe qasja e rregullimit të tyre të jetë në përputhje me praktikën e Komisionit Evropian.

Në lidhje me dy tregjet e tjera, 1.tregu me shumicë i aksesit në një vendndodhje fikse dhe 2.tregu me shumicë i aksesit në kapacitete të dedikuara, AKEP do ti ketë pjesë të listës së listës së tregjeve njësoj si Rekomandimi i Komisionit Evropian (EU) 2020/2245 për tregjet e rregulluara ‘ex-ante’.

Përpos sa më lartë, AKEP ka paraqitur edhe një arsyetim për secilin treg përkatës të listës së tregjeve për rregullim ex-ante të paraqitura në rregulloren e tregjeve përkatëse të AKEP.

1. Tregu me shumicë i aksesit lokal në një vendndodhje fikse

Ky treg përfshin shërbimet që mundësojnë operatorëve të tjerë të aksesojnë infrastrukturën e rrjeteve fikse në nivel lokal, për ofrimin e shërbimeve të tyre fundore, varësisht teknologjisë si, kabllot bakri, fibra optike, nyjet e shpërndarjes, për të ofruar shërbime fundore për abonentët. Ai përfshin format e aksesit si LLU (Local Loop Unbundling), akses në fibra (bitstream, dark fiber) dhe elementë të tjerë pasivë të rrjetit.

Karakteristikat kryesore që justifikojnë përfshirjen e këtij tregu janë:

- Pengesat hyrëse të larta dhe të qëndrueshme, të lidhura me kostot e mëdha të ndërtimit të rrjeteve fikse, sepse kostot e ndërtimit të një rrjeti fiks kombëtar me infrastrukturë në nivel lokal janë jashtëzakonisht të larta, duke përfshirë shpenzime për gërmime, kanalizime, leje ndërtimi dhe lidhje ndërqendrore. Këto pengesa janë të qëndrueshme dhe jo të kapërcyeshme lehtë nga operatorët e rinj.
- Kontrolli mbi infrastrukturën kryesore nga një ose pak operatorë dominues, operatorët ekzistues me rrjete të trashëguara (kryesisht operatorët që kanë shtrirje me te madhe kombëtare, në disa zona rrjete të zhvilluara nga operatorë të tjerë me fibra, etj.) zotërojnë elementë pa të cilët konkurrenca efektive nuk mund të zhvillohet;
- Mungesë zëvendësueshmërie efektive në kërkesë apo ofertë për aksesin në nivel lokal, pasi nuk ekziston një alternativë efektive në ofertë apo kërkesë, ne kushtet kur një operator i ri nuk mund të ndërtojë rrjetin nga e para në mënyrë të qëndrueshme ekonomikisht, dhe konsumatorët nuk kanë mundësi të zëvendësojnë produktin pa akses në rrjet lokal. Nje numer i konsiderueshem i operatorëve alternativë në Shqipëri mbështeten ende në elementët e rrjetit ekzistues për ofrimin e shërbimeve, sidomos në zonat urbane dhe periferike.
- Konkurrencë e kufizuar bazuar në infrastrukturë dhe varësi e operatorëve alternativë nga operatori me rrjetin ekzistues, sepse konkurrenca aktuale zhvillohet kryesisht në bazë shërbimesh dhe jo në bazë infrastrukture. Rrjetet me fibra janë të fragmentuara dhe jo të mbivendosura gjeografikisht.

- Ndërhyrja ex-ante është e nevojshme për të garantuar akses të drejtë, mosdiskriminues dhe transparent, duke mundësuar hyrje të operatorëve të rinj, ulje çmimesh për konsumatorët dhe nxitje të investimeve të ndërsjella në rrjete të reja me fibra.

Mbi këtë bazë, AKEP synon përmes këtij tregu të garantojë konkurrencë efektive në shërbimet me pakicë për aksesin fiks broadband, në përputhje me synimet për përmbushjen e objektivave të nenit 6 të Ligjit nr. 54/2024, dhe të sigurojë që operatorët alternativë të kenë kushte të barabarta për të ofruar shërbime inovative.

2. Tregu me shumicë i aksesit në kapacitete të dedikuara

Ky treg përfshin shërbimet që mundësojnë ofrimin e lidhjeve të dedikuara me kapacitete të garantuara, të përdorura nga operatorët për shërbime me vlerë të shtuar ose për përdorues institucionalë që kërkojnë lidhje të qëndrueshme dhe të sigurt. Ai përfshin shërbime me qira (leased lines), VLAN/VPN, si dhe kapacitete ndërqytetëse ose ndërkombëtare me cilësi të lartë.

Arsyet për përfshirjen e tij si treg i mundshëm për ndërhyrje janë:

- Nevoja për kapacitete të qëndrueshme dhe të garantuara në ofrimin e shërbimeve të transmetimit,
- Pengesat e larta për ndërtim dhe mirëmbajtje të rrjeteve me kapacitete të tilla, pasi ndërtimi i rrjeteve me kapacitete të dedikuara kërkon investime të mëdha në fibra, pajisje transmetimi dhe menaxhim të trafikut. Këto pengesa janë të qëndrueshme në kohë dhe pengojnë hyrjen e operatorëve të rinj në treg;
- Përqendrim i lartë tregu dhe avantazhe strukturore për operatorët me rrjet kombëtar, pasi tregu dominohet nga pak operatorë me rrjete kombëtare që zotërojnë lidhjet tranzite kryesore dhe nyjet strategjike;
- Mungesë konkurrence efektive pa detyrime për akses me kushte të drejta dhe transparente. Në shumë zona, operatorët alternativë nuk kanë akses fizik për të ofruar kapacitete të krahasueshme;
- Ndërhyrja ex-ante synon të sigurojë akses të barabartë në kapacitete, duke shmangur sjelljet diskriminuese apo çmime të pajustificuara, në shërbimet me kapacitete të dedikuara, vlerësohet se është e nevojshme.

Mbi këtë bazë arsyetimi, AKEP synon përmes këtij tregu të sigurojë konkurrencë të qëndrueshme në shërbimet me vlerë të shtuar (VPN, cloud, data centers), të reduktojë varësinë nga operatorët dominues dhe të lehtësojë zhvillimin e tregjeve vertikale që varen nga kapacitetet e dedikuara të komunikimit.

3. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse individuale

Çdo operator që ofron shërbime telefonie fikse ka monopol shërbimi në terminimin e thirrjeve që përfundojnë në rrjetin e tij. Një praktike e konsultuar dhe arsyetuar periodikisht nga AKEP me aktoret e tregut. Ky treg përmbush qartësisht testin e tre kritereve për arsye se:

- Pengesat hyrëse janë absolute, pasi çdo thirrje drejt një numri duhet të përfundojë në rrjetin përkatës;

- Konkurenca nuk ekziston në nivel terminimi, për shkak të natyrës së rrjetit;
- Çmimet e terminimit mund të jenë objekt abuzimi pa kontroll rregullator.
- Praktikë e konsoliduar rregullatore, në përputhje me praktikat e BE-së dhe me qasjen e AKEP ndër vite, tregu i terminimit mbetet objekt i ndërhyrjes ex-ante deri në harmonizimin e plotë të tarifave në koston efiçente të ofrimit të shërbimit të terminimit.
- AKEP e konsideron këtë treg si pjesë të një tranzicioni drejt vendosjes së tarifës unike kombëtare për terminimin e thirrjeve fikse, duke ruajtur ndërkohë barazinë e trajtimit dhe kontrollin e abuzimeve të mundshme;
- AKEP, konsideron faktin se tregjet e terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë fikse dhe asaj celulare janë hequr nga lista e tregjeve nën rregullim nga BE nën argumentimin se këto tregje kanë tendencë të shkojnë drejt konkurrencës efektive si rezultat i vendosjes së tarifës së vetme për terminimin e thirrjeve zanore nga rrjetet fikse dhe mobile (single maximum EU-level wholesale rates for fixed and mobile voice termination (F/MTRs)), por mbetet pjesë e listës së tregjeve për ndërhyrje ex-ante duke konsideruar rrethanat kombëtare dhe synimin për të realizuar në të ardhmen vendosjes së tarifës së vetme për terminimin e thirrjeve zanore nga rrjetet fikse.

AKEP, vlerëson se ndërhyrja ex-ante është e domosdoshme për të vendosur çmime të orientuara në kosto dhe për të siguruar ndërveprueshmëri të drejtë ndërmjet rrjeteve fikse, praktike e aplikuar nga AKEP dhe me synim realizimin e skedulimit kohor të FTR të referuar në dokumentin e analizës së vitit 2025.

4. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile individuale

Ky treg paraqet të njëjtën logjikë strukturore me tregun e terminimit në rrjete fikse, pasi çdo operator celular zotëron monopol shërbimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet. Arsye që e bëjnë këtë treg të përshtatshëm për ndërhyrje ex-ante janë:

- Mungesa e çdo zëvendësueshmërie në kërkesë dhe ofertë për terminimin e thirrjeve;
- Rreziku i çmimeve të larta për terminim, që ndikojnë konkurrencën në tregjet me pakicë, sepse pa ndërhyrje, operatorët mund të vendosin çmime të pabarabarta që ndikojnë konkurrencën në tregjet me pakicë dhe dëmtojnë konkurrueshmërinë ndërmjet operatorëve.
- Simetri e pranuar në nivel BE-je për vendosjen e tarifave të terminimit të barabarta ndër-operatorësh (symmetrical MTRs);
- Nevoja për kontroll të çmimeve në bazë të modeleve të koston, për të garantuar trajtim të barabartë dhe mbrojtje të konsumatorëve.
- Konteksti kombëtar, pavarësisht pse në BE këto tregje janë hequr nga lista e tregjeve të rregulluara për shkak të zbatimit të tarifës unike F/MTR, në Shqipëri kushtet e tregut dhe niveli i konsolidimit të rrjeteve kërkojnë ende mbikëqyrje ex-ante për të shmangur abuzimet e mundshme dhe përgatitur tranzicionin drejt tarifës unike MTR.

AKEP, njëlloj si për terminimin në rrjete fikse, konsideron faktin se tregjet e terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë celulare janë hequr nga lista e tregjeve nën rregullim nga BE nën argumentimin se këto tregje kanë tendencë të shkojnë drejt konkurrencës efektive si rezultat i

vendosjes së tarifës së vetme për terminimin e thirrjeve zanore nga rrjetet fikse dhe mobile (*single maximum EU-level wholesale rates for fixed and mobile voice termination (F/MTRs)*), por mbetet pjese e listës se tregjeve për ndërhyrje ex-ante duke konsideruar rrethanat kombëtare dhe synimin për te realizuar ne te ardhmen vendosjes së tarifës së vetme për terminimin e thirrjeve zanore nga rrjetet celulare në përputhje me praktikën rregullatore evropiane.

ANEKS III – PYETËSOR ORIENTUES PËR KËSHILLIM PUBLIK

AKEP fton palët e interesuara për komentet dhe sugjerimet e tyre mbi draftin e rregullores së analizës së tregut, Udhëzuesin metodologjik (Aneksi I) dhe Arsyetimin për përcaktimin e tregjeve (Aneksi II). Komente të argumentuara do të ndihmojnë për përmirësimin e dokumenteve dhe përafrimin e rregullimit të tregut shqiptar me praktikën më të mirë të BE-së.

I. Pyetje mbi rregulloren e analizës së tregut

1. A konsideroni se struktura e rregullores është e qartë dhe e përshtatshme për të mbuluar të gjitha fazat e analizës së tregut (përkufizim, test i tre kritereve, analizë FNT, vendosje detyrimesh)?
2. A është përfshirë në mënyrë të mjaftueshme baza ligjore dhe referencat e neneve përkatëse të Ligjit nr. 54/2024?
3. A mendoni se afatet për rishikimin e analizave të tregut (neni 4) janë të përshtatshme me dinamikën e tregut dhe zhvillimet teknologjike?
4. A janë parashikuar në mënyrë të qartë procedurat e konsultimit dhe transparencës me publikun (neni 5)?

II. Pyetje mbi Aneksin I– Udhëzuesin metodologjik

1. A konsideroni se udhëzuesi i AKEP (Aneksi I) reflekton në mënyrë të qartë parimet dhe metodologjinë e përdorur nga BE (në veçanti Udhëzuesin SWD(2018)124 final)?
2. A janë përkufizimet e termave (si tregu i produktit, tregu gjeografik, FNT, test i tre kritereve, etj.) të plota dhe të kuptueshme për aktorët e tregut?
3. A e konsideroni të përshtatshëm nivelin e detajimit të udhëzuesit për zbatimin praktik të analizës së tregut nga operatorët dhe palët e interesuara?
4. A mendoni se parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe neutralitetit teknologjik janë reflektuar në mënyrë të qartë në Aneksin I?

III. Pyetje mbi aneksin III – Lista e tregjeve për ndërhyrje ex-ante – përmbledhje e arsyetuar

1. A konsideroni se lista e katër tregjeve të identifikuara për ndërhyrje ex-ante (akses fiks, kapacitete të dedikuara, terminim thirrjesh fiks dhe terminim celular) është e përshtatshme?
2. A e vlerësoni të arsyetuar dhe të përshtatshëm për realitetin shqiptar argumentimin mbi secilin treg të përfshirë në listë?
3. A mendoni se AKEP duhet të analizojë tregje të tjera shtesë jashtë listës së Komisionit Evropian (p.sh. tregje të shërbimeve dixhitale, OTT etj.), apo tregje të tjera në rrethanat kombëtare?

IV. Çështje të tjera pertej strukturimit te pyetjeve me siper

Përveç pyetjeve të mësipërme, AKEP mirëpret komente dhe sugjerime me shkrim për çdo aspekt tjetër të dokumentit dhe propozimeve në këtë projektakt.

Në përgjigjet e dhëna për pyetjet, palët rekomandohet të përfshijnë edhe argumentim për përgjigjet/komentet si dhe sugjerime për përmirësimin e dokumentit.

V. Procedurat e Konsultimit dhe Transparenca

Procesi i konsultimit publik do të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit në faqen e internetit të AKEP, dhe palët e interesuara mund të dërgojnë komentet me shkrim në AKEP si më poshtë:

- në formë shkresore në adresën Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Rr. “Reshit Çollaku”, Tiranë.

- në formë elektronike me email në adresën info@akep.al